



RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT
FINANCIAR
NË
AGJENCINË E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE PUBLIKE TË
INTEGRUARA
PROJEKTI “OFRIMI I SHËRBIMEVE PUBLIKE ME NË QENDËR
QYTETARIN”

DHJETOR 2021

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3
1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	3
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	3
3.	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	3
II.	HYRJA	6
1.	Objekti i auditimit	6
2.	Qëllimi i auditimit	6
3.	Identifikimi i çështjes	6
4.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	6
5.	Përgjegjësitë e audituesve	7
6.	Kriteret e vlerësimit	7
7.	Standardet e auditimit	8
8.	Metodat e auditimit	8
9.	Dokumentimi i auditimit	9
III.	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	10
1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin	10
2.	Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit	12
2.1	Mbi vlerësimin dhe dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare për vitet 2016, 2017 dhe 2020 (në lidhje me shpenzimet në zonat e llogarive 600 dhe 601), nëse janë përgatitur në përputhje me kuadrin e raportimit financiar të aplikueshëm në Shqipëri.	12
2.2	Të tjera që dalin gjatë auditimit	-
IV.	Aneke	48

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi në Agjencinë e Ofrimit të Shërbimeve Publike (ADISA) Projektin ÓOfrimi i shërbimeve publike me në qendër qytetarinô, për periudhën vitet 2016, 2017 dhe nga data 01.01.2020 deri më 31.12.2020, me objekt ÓAuditimi Financiarô. Konkretisht u audituan, marrëveshjet e financimit, menaxhimin financiar të projektit si dhe duke i kushtuar një rëndësi të veçantë dhënies së opinionit mbi shpenzimet në zonat e llogarive 600 ÓPaga personeliô dhe 601 ÓKontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësoreô për Agjencitë pjesëmarrëse të Projektit. Në këtë auditim u angazhuan pesë auditues të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Konkluzionet përkatëse paraqiten në mënyrë më të hollësishme në kapitullin III dhe IV, të këtij Raporti Përfundimtar Auditimi.

2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

Nga auditimi i Raportimeve Financiare (IFR) të përgatitura nga Njësia e Zbatimit të Projektit (PMU) në institucionin ADISA në kuadër të projektit ÓOfrimi i shërbimeve Publike me në Qendër Qytetarinô, për vitet 2016, 2017 dhe 2020, mbi Shpenzimet e programit (EEP) për llogaritë 600 ÓPaga personeliô dhe 601 ÓKontribute për sigurime shoqërore dhe shëndetësoreô për punonjësit e katër Agjencive Pjesëmarrëse të Projektit (ADSIA, AKSHI, ASHK dhe Regjistri Civil) rezultoi se për institucionet ADISA, AKSHI dhe ASHK ka diferenca midis shpenzimeve të raportuara dhe atyre të realizuara.

Theksojmë se këto diferenca janë si pasojë e problematikave të vetë Agjencive Pjesëmarrëse të Projektit (sqarimi i të cilave është identifikuar nga grupi i auditimit dhe është shpjeguar për çdo institucion në vijimësi të materialit) dhe jo si pasojë e konsolidimit të informacionit financiar të raportuara nga PMU. Vetëm në 1 rast ka një diferencë si pasojë e mos mbledhjes së 1 prej tremujorëve tek ASHK, kjo pasi, PMU për përgatitjen e Raporteve Financiare (IFR) mbi shpenzimet e programit EEP, për subjektet buxhetore është bazuar në të dhënat zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit ndërsa për Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (subjekt publik jo buxhetor) në korrespondencat zyrtare periodike.

3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit

Nga auditimi i Raportimeve Financiare (IFR) të përgatitura nga Njësia e Zbatimit të Projektit (PMU) në institucionin ADISA në kuadër të projektit ÓOfrimi i shërbimeve Publike me në Qendër Qytetarinô, për vitet 2016, 2017 dhe 2020, mbi Shpenzimet e programit (EEP) për llogaritë 600 ÓPaga personeliô dhe 601 ÓKontribute për sigurime shoqërore dhe shëndetësoreô për punonjësit e katër Agjencive Pjesëmarrëse të Projektit (ADSIA, AKSHI, ASHK dhe Regjistri Civil) rezultoi se për institucionet ADISA, AKSHI dhe ASHK ka diferenca midis shpenzimeve të raportuara dhe atyre të realizuara. Në tabelën e mëposhtme pasqyrohen diferencat e rezultuara nga auditimi lidhur me këto shpenzime:

Tabela nr.1: Krahësim i vlerave të raportuara me faktike

në lekë					
Institucione	Vitet	Llogaritë	Shpenzimet e rezultuara nga auditimi	Shpenzimet e realizuara vjetore të raportuara	Diferenca
AKSHI	2016	Llog. 600	75,068,637	75,068,637	-
		Llog. 601	11,900,007	11,900,007	-

ADISA	2017	Llog. 600	84,486,300	84,468,000	18,301
		Llog. 601	13,469,386	13,469,000	386
	2020	Llog. 600	67,102,990	67,102,990	-
		Llog. 601	11,024,860	11,024,860	-
	2016	Llog. 600	51,953,784	51,953,784	-
		Llog. 601	8,554,784	8,554,784	-
	2017	Llog. 600	85,025,237	85,025,237	-
		Llog. 601	14,062,789	14,062,789	-
	2020	Llog. 600	105,246,420	105,246,420	-
		Llog. 601	17,497,988	17,497,988	-
ASHK (ish ZRPP)	2016	Llog. 600	531,502,235	529,565,000	1,937,235
		Llog. 601	90,461,037	88,483,000	1,978,037
	2017	Llog. 600	566,517,496	566,516,000	1,496
		Llog. 601	93,963,377	94,099,000	-135,623
	2020	Llog. 600	1,269,426,235	1,269,426,235	0
		Llog. 601	210,595,881	210,595,881	0
R. Civil	2016	Llog. 600	307,019,155	307,019,155	-
		Llog. 601	50,144,000	50,144,000	-
	2017	Llog. 600	327,016,799	326,382,000	634,799
		Llog. 601	54,271,401	54,269,000	2,401
	2020	Llog. 600	335,477,714	335,466,000	11,714
		Llog. 601	55,559,954	55,560,000	46

Burimi: Sistemi i Thesarit dhe ADISA

Theksojmë se këto diferenca janë si pasojë e problematikave të vetë Agjencive Pjesëmarrëse të Projektit (sqarimi i të cilave është identifikuar nga grupi i auditimit dhe është shpjeguar për çdo institucion në vijimësi të materialit) dhe jo si pasojë e konsolidimit të informacionit financiar të raportuara nga PMU. Vetëm në 1 rast ka një diferencë si pasojë e mos mbledhjes së 1 prej tremujorëve tek ASHK, kjo pasi, PMU për përgatitjen e Raportëve Financiare (IFR) mbi shpenzimet e programit EEP, për subjektet buxhetore është bazuar në të dhënat zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit ndërsa për Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (subjekt publik jo buxhetor) në korrespondencat zyrtare periodike.

Opinion i Auditimit

Opinion i pakualifikuar

Opinion i shprehur mbi Raportet Financiare (IFR) për vitet 2016, 2017 dhe viti 2020. Grupi i auditimit të KLSH-së, ka audituar Raportet Financiare (IFR) të shpenzimeve të ligjshme të programit (EEP) të cilat përfshijnë shpenzimet e llogarive 600 óPaga personelió dhe 601 óKontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësoreó të Agjencive Pjesëmarrëse të Projektit (Regjistri Civil, AKSHI, ADISA dhe ASHK/Ish-ZRPP) për periudhën vitet 2016, 2017 dhe nga data 01.01.2020 deri më 31.12.2020. Auditimi është bazuar në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, óPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitó, Rregulloren e Procedurave të Auditimit në KLSH, Manualin e Auditimit Financiar, Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të zbatueshme për Institucionet Supreme të Auditimit (ISSAI 1000-1999), në parimet ISSAI-P1, óDeklarata e Limësó; ISSAI P-10, óDeklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-tó, si dhe Standardeve të Auditimit të Sektorit Publik ISSAI 200, 2000, 2200-2810.

Në opinionin tonë, bazuar në punën e kryer në auditim, është marrë siguri e arsyeshme dhe është siguruar një evidencë e mjaftueshme, e përshtatshme dhe relevante për të arritur në konkluzionin se Raportet Financiare (IFR) në aspektin material paraqesin një pamje të vërtetë dhe janë përgatitur në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi për raportimin financiar sipas marrëveshjes së huasë të ratifikuar me Ligjin nr. 3/2016, datë 28.01.2016, óPër ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për Projektin óOfrimi i shërbimeve publike me në qendër qytetarinó. Nga auditimi i shpenzimeve për llogaritë (600, 601) në Agjencitë Pjesëmarrëse të Projektit me shpenzimet e raportuar në

Raportet Financiare (IFR) nuk rezultuan diferenca materiale, rezultat ky i cili justifikon dhënien e një Opinionit të pakualifikuar.

Baza për Opinionin e pakualifikuar

Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit nuk ka devijime materiale dhe opinionin i dhënë mbështetet në faktin se devijimet e konstatuara për shpenzimet e ligjshme të programit (EEP) për llogaritë (600 dhe 601) të raportuara nga Agjencitë Pjesëmarrëse (Regjistri Civil, AKSHI, ADISA dhe ASHK/ish-ZRPP) në zyrën e Njësisë së Menaxhimit të Projektit (PMU) pranë ADISA përmbajnë gabime të cilat në gjykimin profesional të audituesve të pavarur nuk janë të përhapura dhe janë nën kufirin e vlerave materiale, që justifikon dhënien e opinionit të pakualifikuar

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese

Strukturat drejtuese të Agjencisë së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA), Njësia e Menaxhimit të Projektit (PMU) si dhe Agjencitë Pjesëmarrëse të Projektit (Regjistri Civil, AKSHI, ADISA dhe ASHK/ish-ZRPP) janë përgjegjëse për koordinimin e duhur, funksionimin dhe për raportimin e drejtë dhe të saktë duke respektuar aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, si dhe menaxhimin e Projektit duke pasur në konsideratë shpenzimin e fondeve me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet. Ndërsa Agjencitë pjesëmarrëse të cilat ofrojnë shërbime administrative, janë përgjegjëse për realizimin e shpenzimeve të ligjshme sipas programit EEP për llogaritë (600, 601) të cilat mbulohen nga Projekti.

Përgjegjësitë e audituesve

Objektivat e punës sonë lidhen me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse paraqiten anomali materiale, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion mbi shpenzimet e ligjshme sipas programit (EEP) për llogaritë (600, 601) të cilat mbulohen nga Projekti për agjencitë pjesëmarrëse. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Anomalitë mund të lindin nga gabimet apo mashtrimet dhe konsiderohen si materiale, nëse individualisht ose në tërësi ato influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të raportit. Përveç Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI-t), ne gjithashtu aplikojmë edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese. Konkluzionet tona janë të bazuara në punën audituese, deri në përgatitjen e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarje apo kushte specifike në të ardhmen mund të ndryshojnë situatën aktuale agjencive pjesëmarrësve të Projektit. Gjithashtu, ne u mundësojmë drejtuesve një deklaratë në lidhje me kërkesat etike të pavarësisë sipas të cilave ne kemi kryer punën tonë audituese dhe komunikojmë me ta në rastet kur ekziston konflikt interesi apo çështje të tjera lidhur me etikën. Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin financiar dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, óPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 1179/1 prot., datë 03.11.2021, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 03.11.2021 deri më datë 03.12.2021, në subjektin Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA), për Projektin óOfrimi i shërbimeve publike me në qendër qytetarin, për periudhën vitet 2016, 2017 dhe 2020, u krye auditimi óMbi auditimin financiar nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. I.S., Përgjegjëse Grupi
2. B. Sh., Auditues
3. E. C., Auditues

a) Titulli:Raport Përfundimtar i auditimit financiar në agjencinë e ofrimit të shërbimeve publike të integruara projekti óOfrimi i shërbimeve publike me në qendër qytetarin

b) Marrësi: Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA)

c) Objektivat dhe qëllimi : Objektivi i Auditimit Financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare për llogaritë 600, 601 (për vitet 2016, 2017 dhe 2020) nuk kanë devijime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimeve, duke i mundësuar audituesit të shprehë opinion nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kuadrin rregullator të zbatueshëm për raportimin financiar si dhe raportimi mbi pasqyrat financiare dhe komunikimi siç kërkohet nga ISSAI-të, në përputhje me gjetjet e auditimit tek përdoruesit, drejtuesit, personat përgjegjës, ose palët jashtë entitetit, në lidhje me çështjet që rrjedhin nga auditimi.

Auditimi ka për qëllim *promovimin e transparencës* duke ofruar raporte të besueshme për fondet nëse janë raportuar siç kërkohet si dhe nëse janë arritur apo jo objektivat e Projektit. Gjithashtu, projekti i auditimit ka për qëllim *promovimin e përgjegjshmërisë* ndaj devijimeve të raportimit dhe ndaj shkeljeve të kuadrit ligjor, në mënyrë që të mund të merren veprime korrigjuese dhe personat përgjegjës të përgjigjen për veprimet e tyre. Auditimi Financiar i ndërmarrë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ka për qëllim promovimin e qeverisjes së mirë në sektorin publik duke marrë parasysh riskun e mashtrimit në lidhje me përputhshmërinë (*sipas ISSAI 1240*).

d) Identifikimi i çështjes: Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA), Njësia e Menaxhimit të Projektit, duhet të ketë organizimin e duhur, duhet të funksionojnë duke respektuar aktet ligjore e nënligjore në fuqi dhe udhëzuesit e donatorëve, për menaxhimin e projektit me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet, me synim arritjen e objektivave të projektit:

- Rritjen e efikasitetit në ofrimin e shërbimeve publike nëpërmjet reduktimit të kohës së përpunimit, të matur nga reduktimi i kohës që kërkohet për qytetarët për të marrë shërbime publike të zgjedhura (të krijuara nga anketat periodike).
- Rritjen e aksesit të shtresës së varfër dhe të pambrojturve, e matur nga përqindja e të varfërve dhe të pambrojturve që përdorin shërbimet publike (të gjeneruara nga anketime periodike, të ndara sipas gjinisë dhe grupit të të ardhurave).

e) Përgjegjësitë e strukturave drejtuese: Strukturat drejtuese të Agjencisë së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA), Njësia e Menaxhimit të Projektit (PMU) si dhe Agjencitë Pjesëmarrëse të Projektit (Regjistri Civil, AKSHI, ADISA dhe ASHK/ish-ZRPP) janë përgjegjëse për koordinimin e duhur, funksionimin dhe për raportimin e drejtë dhe të saktëduke respektuar aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, si dhe menaxhimin e Projektit duke pasur në konsideratë shpenzimin e fondeve me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet. Ndërsa Agjencitë pjesëmarrëse të cilat ofrojnë shërbime administrative, janë përgjegjëse për realizimin e shpenzimeve të ligjshme sipas programit EEP për llogaritë (600, 601) të cilat mbulohen nga Projekti.

f) Përgjegjësitë e audituesve: Objektivat e punës sonë lidhen me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse paraqiten anomali materiale si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion mbi shpenzimet e ligjshme sipas programit (EEP) për llogaritë (600, 601) të cilat mbulohen nga Projekti për agjencitë pjesëmarrëse. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Anomalitë mund të lindin nga gabimet apo mashtrimet dhe konsiderohen si materiale, nëse individualisht ose në tërësi ato influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të raportit. Përveç standardeve të ISSAI, ne gjithashtu aplikojmë edhe gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese. Konkluzionet tona janë të bazuara në punën audituese, deri në përgatitjen e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarje apo kushte specifike në të ardhmen mund të ndryshojnë situatën aktuale agjencive pjesëmarrëse të Projektit. Gjithashtu, ne u mundësojmë drejtuesve një deklaratë në lidhje me kërkesat etike të pavarësisë sipas të cilave ne kemi kryer punën tonë audituese dhe komunikojmë me ta në rastet kur ekziston konflikt interesi apo çështje të tjera lidhur me etikën. Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin financiar dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

g) Kriteret e vlerësimit: Standardet Ndërkombëtare të INTOSAI-t, ISSAI 300 óStandardet e Fushës së Auditimit Shtetëroró; ISSAI 400 óStandardet e Raportimit në Auditimin Shtetëroró; ISSAI 1000-2999 óUdhëzues i Auditimit Financiaró; Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014, óPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitó; Ligji nr. 3/2016, datë 28.01.2016, óPër ratifikimin e Marrëveshjes së Huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për Projektin óOfrimi i shërbimeve publike me në qendër qytetarinó; Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, óPër menaxhimin financiar dhe kontrollinó i ndryshuar; Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, óPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëó i ndryshuar; Ligji nr. 8379, datë 29.07.1998, óPër hartimin dhe zbatimin e buxhetit të Shtetit në Republikën e Shqipërisëó i ndryshuar; Ligji nr. 25/2018, datë 10.05.2018, óPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareó i ndryshuar; Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995, óKodi i Punës i Republikës së Shqipërisëó i ndryshuar; Ligji nr. 152/2013, datë 30.05.2013, óPër nëpunësin civiló i ndryshuar; VKM nr. 775, datë 24.09.2010, óPër administrimin e financimeve të huaja në Republikën e Shqipërisëó; VKM nr. 187, datë 08.03.2017, óPër miratimin e strukturës dhe të nivelit të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, Zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, Aparatet e Ministrive të Linjës, administratën e

Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Gjykatën e Lartë, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e Prefektit; Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 20, datë 24.12.2003, për përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore të njësive të menaxhimit/zbatimit të projekteve dhe marrëveshjeve me donatorët e huaj; Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011, për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik i ndryshuar; Udhëzimi nr. 8, datë 17.02.2003, për evidentimin, regjistrimin, përdorimin dhe raportimin e financimeve të huaja, në kuadrin e projekteve dhe marrëveshjeve me donatorët e huaj; Rregulloren e Brendshme mbi organizimin dhe funksionimin e KLSH-së, miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 85, datë 30.06.2015, i ndryshuar; Rregullore për procedurat e auditimit të KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 63, datë 22.06.2020, të Kryetarit të KLSH-së, i ndryshuar; Manuali i Auditimit Financiar miratuar sipas Vendimit të Kryetarit të KLSH-së me nr. 64, datë 22.06.2020.

h) Standardet e auditimit:

Standardet e zbatuara gjatë kryerjes së auditimit:

- ISSAI 100 për parimet themelore të auditimit të sektorit publik që përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi.
- ISSAI 200 për parimet themelore të auditimit financiar që përcakton parimet themelore të ISSAI 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të pasqyrave financiare.
- ISSAI 1000-2999 për Udhëzues të Auditimit Financiar.
- ISSAI 1300 për Planifikimin e auditimit të pasqyrave financiare.
- INTOSAI GOV 9100 për Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik.
- INTOSAI GOV 9110 për Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshme.
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve IFAC.
- Manualin e Auditimit Financiar të Gjykatës Evropiane të Audituesve.
- Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi auditimin financiar.
- Kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (IPSAS).
- Manuali i Auditimit Financiar miratuar sipas Vendimit të Kryetarit të KLSH-së nr. 64, datë 22.06.2020.
- Kodi Etik i KLSH-së.

Metodat e auditimit

- ✓ Për arritjen e objektivave, metoda e auditimit u bazua tek risku dhe kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit. Në kryerjen e auditimit janë përdorur metoda e bazuar në funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, metoda e bazuar në procedurat bazë dhe në procedurat analitike. Pas testimit të kryer, për të kuptuar sesi funksionon sistemi i kontrollit të brendshëm dhe pas marrjes së informacionit në mënyrë të përgjithshme, u bënë teste në ushtrimin e auditimit për saktësinë e raportimit të aktivitetit ekonomik.
- ✓ Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm morëm dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ja nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e audituesve.

- ✓ Po kështu nga ana jonë u përshkrua legjislacioni autorizues, rregullat e vendosura sipas legjislacionit autorizues, caktimi i përgjegjësisë dhe autoritetit, etj.
- ✓ Teknikat e kontrollit të përdorura gjatë auditimit janë; kontrolli aritmetik, kontrolli me anë të pjesëve justifikuese, inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese, kontrolli i vlerësimit, konfirmim nga të tretët, kontrolli sipas një treguesi.

Dokumentimi i auditimit

Dokumentimi i rezultateve të auditimit është kryer duke u bazuar në kërkesat e Manualit të Auditimit Financiar miratuar sipas Vendimit të Kryetarit të KLSH-së nr. 64, datë 22.06.2020, si dhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit ISSAI 1230 *Dokumentimi i auditimit*. Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundur dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet e rëndësishme profesionale të bëra në arritjen e konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

1. Mbi auditimin e marrëveshjes të projektit me huadhënësit, ndryshimet e tyre nëse kanë, shkaqet dhe argumentimi i ndryshimit.

U audituan angazhimet e parashikuara në Marrëveshjen e Huas lidhur me donatorin Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD) e ratifikuar me Ligjin nr. 3/2016, datë 28.01.2016, *ÓPër ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për Projektin ÓOfrimi i shërbimeve publike me në qendër qytetarinó*.

2. Mbi menaxhimin financiar të projektit, shkallën e realizimit të disbursimeve financiare të fondeve kundrejt nivelit të programuar. Raportimi i tyre në Ministrinë e Financave.

Në lidhje me menaxhimin financiar të Projektit u audituan praktikat e ndjekura në zbatim të Marrëveshjes së Huas së lidhur me EBRD mbi mbulimin me financim nga ana e tyre, dhe disbursimet e realizuara së bashku me dokumentacionin plotësues. Dokumentacioni raportues në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe raportet e ndërmjetme, raportet e realizimit, korrespondencat me Bankën Botërore mbi realizimin e disbursimeve.

3. Mbi vlerësimin dhe dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare për vitet 2016-2017 dhe viti 2020 (në lidhje me shpenzimet në zonat e llogarive 600 dhe 601), nëse janë përgatitur në përputhje me kuadrin e raportimit financiar të aplikueshëm në Shqipëri.

4. Auditim me zgjedhje në ADISA.

II. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.

Për realizimin e Projektit ÓOfrimi i shërbimeve publike me në qendër qytetarinô, është marrë kredi nga Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim nëpërmjet Marrëveshjes së Huas të ratifikuar me Ligjin nr. 3/2016, datë 28.01.2016, óPër ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për Projektin ÓOfrimi i shërbimeve publike me në qendër qytetarinô.

Objektivat kryesorë të Projektit janë:

1. Rritja e efikasitetit në ofrimin e shërbimeve publike nëpërmjet reduktimit të kohës së përpunimit, të matur nga reduktimi i kohës që kërkohet për qytetarët për të marrë shërbime publike të zgjedhura (të krijuara nga anketat periodike).

2. Rritja e aksesit të shtresës së varfër dhe të pambrojturve, e matur nga përqindja e të varfërve dhe të pambrojturve që përdorin shërbimet publike (të gjeneruara nga anketime periodike, të ndara sipas gjinisë dhe grupit të të ardhurave).

Për realizimin e këtyre objektivave, Huaja e marrë sipas marrëveshjes së sipërcituar është në vlerën 29,300,000 Euro. Pagesat e principalit do kryhen çdo datë 15 janar dhe 15 korrik, duke filluar më 15 janar 2023 dhe duke përfunduar më datë 15 janar 2035.

Njësinë e Menaxhimit të Projektit (PMU) e ngritur pranë ADISA-s është struktura përgjegjëse për implementimin e Projektit. Kjo njësi është përgjegjëse për menaxhimin e rregullt të Projektit si dhe për koordinimin e nevojshëm me IBRD.

Auditimi financiar nga ana e KLSH është kryer mes të tjerave dhe në bazë të detyrimeve që lindin nga Ligji nr. 3/2016, datë 28.01.2016 óPër ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin ÓOfrimi i shërbimeve publike me në qendër qytetarinô si dhe parashikimeve të bëra nga Manualin Operacional të Projektit (POM), kapitulli VII. Menaxhimi Financiar.

Në kuadër të sa më sipër si dhe në bazë të shkresës së datës 27.07.2020, të dërguar në KLSH nga përfaqësuesit e Bankës Botërore M. S., komunikimit të vazhdueshëm on-line dhe materialeve të dërguara në mënyrë elektronike nga znj. J. M. (Specialiste e Menaxhimit Financiar Bankës Botërore), si dhe nga takimi i kryer me subjektin me datë 02.11.2021, auditimi është përqendruar për dhënien e opinionit për shpenzimet e pagave dhe sigurimeve për subjektet përfituese si pjesë e projektit, për vitet 2016, 2017 dhe 2020.

Për kategorinë e parë, Programi i shpenzime të miratuara sipas pjesëve 1(a), 2(a) dhe 3(a) të Projektit është planifikuar **Vlera 22,895,000 EUR**. Ky program përfshinë shpenzimet për **mbështetjen e Buxhetin e Shtetit (EEP)** dhe do të disbursohet sipas një grafiku të caktuar pas realizimit të 5 DLI-ve (*DLI: treguesit specifikë të produkteve dhe rezultateve që matin përmirësimin e përmbushjes së detyrave të cilësisë dhe mundësive për marrjen e shërbimeve administrative të ofruara nga Huamarrësi*) të ndara sipas viteve.

Për kategorinë e dytë: Vlera 4,431,750 EUR, disbursohet dhe shërben për prokurimin e mallrave, shërbimeve dhe konsulencës, të cilat do të shërbejnë për realizimin e 5 DLI-ve.

Vlera e planifikuar fillimisht me ligjin nr.3/2016 është rishikuar me VKM Nr. 519 datë 25.07.2019 ku **vlera 4,431,750 EUR** është rialokuar në vlerën 6,326,242 Euro.

Për kategorinë e tretë: Kthimi i paradhënies së përgatitjes së projektit, është rishikuar vlera prej 1,900,000 Euro e planifikuar fillimisht me ligjin nr.3/2016. Ky ndryshim është bërë referuar VKM Nr. 519 datë 25.07.2019 Për miratimin e marrëveshjes ndryshuese me shkëmbim notash,

të marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), për projektin ÓOfrimi i Shërbimeve me në qendër Qytetarinô, shuma e huas së alokuar për këtë kategori është reduktuar në 5,507 Euro.

Për kategorinë e katërt: Tarifa fillestare është disbursuar 100%, në vlerën 73,250 Euro e cila është mbajtur nga Banka që me bërjen efektive të kredisë.

Pagesat e principalit do kryhen çdo datë 15 janar dhe 15 korrik, duke filluar më 15 janar 2023 dhe duke përfunduar më datë 15 janar 2035.

Bazuar në Manualin Operacional të Projektit (POM) shpenzimet të ligjshme që do të mbulohen nga projekti janë pagat dhe kontributi për sigurime shoqërore për Institucione Buxhetore dhe Jobuxhetore.

Për Institucionet Buxhetore shpenzimet e ligjshme janë pagat dhe kontributet shoqërore për:

1. Zyrat e Gjendjes Civile në 61 bashki të Ministrisë së Brendshme.
2. Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit-AKSHI.
3. Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara-ADISA

Për Institucionet Jobuxhetore shpenzimet e ligjshme janë pagat dhe kontributet shoqërore për

1. Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (aktualisht Agjencia Shtetërore e Kadastrës).

Nga auditimi i Raportimeve Financiare (IFR) të përgatitura nga Njësia e Zbatimit të Projektit (PMU) në institucionin ADISA në kuadër të projektit ÓOfrimi i shërbimeve Publike me në Qendër Qytetarinô, për vitet 2016, 2017 dhe 2020, mbi Shpenzimet e programit (EEP) për llogaritë 600 ÓPaga personeliô dhe 601 ÓKontribute për sigurime shoqërore dhe shëndetësoreô për punonjësit e katër Agjencive Pjesëmarrëse të Projektit (ADISA, AKSHI, ASHK dhe Regjistri Civil) rezultoi se për institucionet ADISA, AKSHI dhe ASHK ka diferenca midis shpenzimeve të raportuara dhe atyre të realizuara. Në tabelën e mëposhtme pasqyrohen diferencat e rezultuara nga auditimi lidhur me këto shpenzime:

Tabela nr.1: Krahasim i vlerave të raportuara me faktike

në lekë

Institucione	Vitet	Llogaritë	Shpenzimet e rezultuara nga auditimi	Shpenzimet e realizuara vjetore të raportuara	Diferenca
AKSHI	2016	Llog. 600	75,068,637	75,068,637	-
		Llog. 601	11,900,007	11,900,007	-
	2017	Llog. 600	84,486,300	84,468,000	18,301
		Llog. 601	13,469,386	13,469,000	386
	2020	Llog. 600	67,102,990	67,102,990	-
		Llog. 601	11,024,860	11,024,860	-
ADISA	2016	Llog. 600	51,953,784	51,953,784	-
		Llog. 601	8,554,784	8,554,784	-
	2017	Llog. 600	85,025,237	85,025,237	-
		Llog. 601	14,062,789	14,062,789	-
	2020	Llog. 600	105,246,420	105,246,420	-
		Llog. 601	17,497,988	17,497,988	-
ASHK (ish ZRPP)	2016	Llog. 600	531,502,235	529,565,000	1,937,235
		Llog. 601	90,461,037	88,483,000	1,978,037
	2017	Llog. 600	566,517,496	566,516,000	1,496
		Llog. 601	93,963,377	94,099,000	-135,623
	2020	Llog. 600	1,269,426,235	1,269,426,235	0
		Llog. 601	210,595,881	210,595,881	0
R. Civil	2016	Llog. 600	307,019,155	307,019,155	-
		Llog. 601	50,144,000	50,144,000	-
	2017	Llog. 600	327,016,799	326,382,000	634,799
		Llog. 601	54,271,401	54,269,000	2,401
	2020	Llog. 600	335,477,714	335,466,000	11,714

	Llog. 601	55,559,954	55,560,000	46
--	-----------	------------	------------	----

Burimi: Sistemi i Thesarit dhe ADISA

Theksojmë se këto diferenca janë si pasojë e problematikave të vetë Agjencive Pjesëmarrëse të Projektit (sqarimi i të cilave është identifikuar nga grupi i auditimit dhe është shpjeguar për çdo institucion në vijimësi të materialit) dhe jo si pasojë e konsolidimit të informacionit financiar të raportuara nga PMU. Vetëm në 1 rast ka një diferencë si pasojë e mos mbledhjes së 1 prej tremujorëve tek ASHK.

Kjo pasi, PMU për përgatitjen e Raporteve Financiare (IFR) mbi shpenzimet e programit EEP, për subjektet buxhetore është bazuar në të dhënat zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit ndërsa për Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (subjekt publik jo buxhetor) në korrespondencat zyrtare periodike.

2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit

2.1. Mbi vlerësimin dhe dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare për vitet 2018-2019 (në lidhje me shpenzimet në zonat e llogarive 600 dhe 601), nëse janë përgatitur në përputhje me kuadrin e raportimit financiar të aplikueshëm në Shqipëri.

Në zbatim të pikës së Programit të Auditimit nr. 1179/1 prot, datë 03.11.2021, “*Mbi auditimin financiar për projektin “Ofrimi i Shërbimeve Publike me në Qendër Qytetarin” në Agjencinë e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara.*”, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- 1- *Evidencat Statistike të hartuara nga Drejtoria e Ekonomike pranë ADISA;*
- 2- *Evidencat Statistike të hartuara nga Zyrtat e Gjendjes Civile pranë Ministrisë së Brendshme*
- 3- *Pasqyrat Financiare të dorëzuara në Degën e Thesarit nga ADISA për vitet 2016, 2017 dhe 2020;*
- 4- *Pagesat e realizuara nëpërmjet Thesarit për shpenzimet dhe të ardhurat për vitin 2016, 2017 dhe 2020 në Sistemin AMoFTS, për realizimin e Cash/Accrual ;*
- 5- *Listë pagesat, urdhër shpenzimet e thesarit dhe deklarimeve në sistemin e tatimeve për vitet 2016, 2017 dhe 2020;*
- 6- *Raportimet Financiare (IFRs) që Njësia e Menaxhimit të Projektit (PMU) i ka dërguar pranë EBRD për vitet 2016, 2017 dhe 2020.*

2.1. AGJENCIA E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE PUBLIKE TË INTEGRUARA (ADISA)

Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA) është një institucion publik i organizuar në formën e agjencisë autonome në varësi të Kryeministrit, e cila është krijuar dhe ushtron veprimtarinë administrative në bazë të Ligjit nr. 13/2016, datë 18.02.2016, óPër mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë. Marrëdhëniet e punës me punonjësit e saj i ka rregulluar me anë të kontratave individuale të punës bazuar në Ligjin nr. 9152, datë 29.07.2003, óKodi i punës i Republikës së Shqipërisë i ndryshuar. Strukturat organizative në mënyrë kronologjike deri në vitin 2020 kanë ndryshuar me miratimin e Vendimeve të Këshillit të Ministrave si më poshtë;

- Me VKM nr. 654 datë 14.09.2016 óPër miratimin e strukturës dhe të organikës së ADISAô
- Me VKM nr. 306, datë 05.04.2017, óPër disa ndryshime në VKM nr. 654, datë 14.09.2016, për miratimin e strukturës dhe të organikës së ADISAô, është miratuar struktura organizative për

vitin 2018 me numër 160 punonjës, ku gjatë vitit 2018 janë punësuar 18 punonjës dhe i kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës 12 punonjës.

- Me VKM nr. 28, datë 23.01.2019, óPër disa ndryshime në VKM nr. 654, datë 14.09.2016, për miratimin e strukturës dhe të organikës së ADISAô i ndryshuar, është miratuar struktura organizative për vitin 2019 me numër 155 punonjës, ku gjatë vitit 2019 janë punësuar 29 punonjës dhe i kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës 24 punonjës.

- Me VKM nr. 758, datë 11.12.2019, óPër disa ndryshime në VKM nr. 654, datë 14.09.2016, për miratimin e strukturës dhe të organikës së ADISAô i ndryshuar, është miratuar struktura organizative për vitin 2019 me numër 175 punonjës, ku gjatë vitit 2019 janë punësuar 29 punonjës dhe i kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës 24 punonjës.

- Me VKM nr. 797, datë 12.10.2020, óPër disa ndryshime në VKM nr. 654, datë 14.09.2016, për miratimin e strukturës dhe të organikës së ADISAô i ndryshuar, është miratuar struktura organizative për vitin 2020 me numër 185 punonjës, ku gjatë vitit 2020 janë punësuar 43 punonjës dhe i kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës 33 punonjës.

Kriteret e punësimit për secilin pozicion pune janë miratuar sipas vendimeve të Këshillit Drejtues konkretisht, ADISA është bazuar në ;

-VKD nr. 2, datë 03.10.2016, ku është miratuar óRregullore e brendshme për organizimin dhe funksionimin e administratës për ADISAô për vitin 2016 dhe 2017

- VKD nr. 7, datë 09.05.2019 ku është miratuar si dokument më vete óDetyrat funksionale dhe kriteret e punësimit në ADISAô

- për vitin 2020 dhe deri në përfundim të periudhës objekt auditimi në VKD nr.10, datë 22.02.2021 ó Për disa shtesa dhe ndryshime në detyrat funksionale dhe kriteret e punësimit në ADISAô.

ADISA në lidhje me caktimin e nivelit të pagave është bazuar në referencat e përcaktuara në VKM-në nr. 187, datë 08.03.2017, óPër miratimin e strukturës dhe nivelit të pagave.....ô. Pagat janë të grupuara në katër nivele për secilin pozicion pune konkretisht niveli I, II, III dhe IV dhe secili nivel ka një limit të përcaktuar. Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, lidhur me procedurat të cilat janë ndjekur nga ADISA për mbajtjen e pagave konstatohet se:

Listë pagesat përfshijnë, kategorinë (nivele e pagës), pagën për funksion, pagën e grupit (diplomën e nivelit të parë bachelor si dhe diplomën e nivelit të dytë master shkencor dhe profesional), raportet mjekësore të paguara nga punëmarrësi, shtesa për vjetërsi pune, pagën bruto mujore, ndalesa (kontribute për sigurime shoqërore 9.5%, kontribute për sigurimet shëndetësore 1.7%, tatimi mbi pagën, sigurimin suplementar). Listë prezencat janë hartuar sipas ditëve gjithsej të punës për çdo punonjës. Paga e aplikuar minimale është 29,500 lekë paga maksimale 118,100 lekë. Për sa i përket shpërblimeve për orët jashtë orarit të punës nuk ka, për shkak se nuk janë shfrytëzuar orët jashtë orarit zyrtar, pasi punonjësit i përmbahen 40 orëve në javë, sipas orarit të shpallur në rregulloren e brendshme të institucionit si dhe në përputhje me kontrata individuale të punës.

Për periudhën e 2016 në 2017, në funksion të auditimit të llogaritjes së pagave në përputhje me VKM-së 187, datë 08.03.2017, me përzgjedhje u auditua përputhja dokumentare e 16 dosjeve të personelit të ADISA-s me pagesat e pagave përkatëse, përzgjedhje kjo e kryer në mënyrë rastësore, për muajt shtator 2016 shkurt 2017, qershor 2017 dhe dhjetor 2017, duke u bazuar në këto nivele të pagave (III-a, IV-a, IV-b, IV-c). Si rezultat i testimit nuk janë gjetur diferenca ndërmjet rillogaritjes tonë dhe llogaritjes nga ana e Drejtorisë Ekonomike;

Tabela nr.2: Rillogaritje pagash

në lekë

Testi i pagave		Rillogaritja e Pagës							Fakti	Diferenca			
Nr	Emër mbiemër	Shkurt 2016									Rillogaritja Sipas VKM	Paga sipas Borderosë	Diferenca
		Kategoria	Paga grupi	Paga funksioni	Vjetërsia								
					Paga grupi	Vite	%	Shuma					
1	E. U.	IV-c	14,000	29,500	14,000	0	2%	-	43,500	43,500	-		
2	S. F.	IV-c	14,000	29,500	14,000	0	2%	-	43,500	43,500	-		
3	M. M.	IV-b	14,000	38,000	14,000	0	2%	-	52,000	52,000	-		
4	R.M.	IV-b	11,000	38,000	11,000	0	2%	-	49,000	49,000	-		
Nr	Emër mbiemër	Qershor 2017							Paga bruto	Paga sipas Borderosë	Diferenca		
		Kategoria	Paga grupi	Paga funksioni	Vjetërsia								
					Paga grupi	Vite	%	Shuma					
1	G. H.	IV-b	14,000	38,000	14,000	4	2%	1,120	53,120	53,120	-		
2	I. B.	IV-b	14,000	38,000	14,000	2	2%	560	52,560	52,560	-		
3	P. T.	IV-b	14,000	38,000	14,000	0	2%	-	52,000	52,000	-		
4	A. J.	IV-a	14,000	49,000	14,000	23	2%	6,440	69,440	69,440	-		
Nr	Emër mbiemër	Dhjetor 2017							Paga bruto	Paga sipas Borderosë	Diferenca		
		Kategoria	Paga grupi	Paga funksioni	Vjetërsia								
					Paga grupi	Vite	%	Shuma					
1	S. T.	IV-a	14,000	49,000	14,000	8	2%	2,240	65,240	65,240	-		
2	A.D.	IV-a	14,000	49,000	14,000	2	2%	560	63,560	63,560	-		
3	E. Ç.	III-a/1	14,000	70,500	14,000	6	2%	1,680	86,180	86,180	-		
4	E.N.	IV-a	14,000	49,000	14,000	3	2%	840	63,840	63,840	-		

Burimi: ADISA përpunuar nga grupi i auditimit

Gjithashtu është vepruar në të njëjtën mënyrë dhe për vitin 2020 duke përzgjedhur për testim dosjet e 8 punonjësve dhe është rillogaritur pagesa bazuar në VKM-së 187, datë 08.03.2017 për muajt shkurt, maj, shtator dhe dhjetor 2020. Si rezultat i testimit nuk janë gjetur diferenca ndërmjet rillogaritjes tonë dhe llogaritjes nga ana e Drejtorisë Ekonomike;

Tabela nr.3: Rillogaritje pagash

në lekë

Testi i pagave		Rillogaritja e Pages								Fakti	Diferenca
Nr	Emër mbiemër	Shkurt, Maj, Shtator, Dhjetor 2020									Diferenca
		Kategoria	Paga grupi	Paga funksioni	Vjetërsia			Paga bruto	Paga sipas Borderosë		
					Paga grupi	Vite	%			Shuma	
1	A. N.	III-b	14,000	61,000	14,000	8	2%	2,240	77,240	77,240	-
2	B. H.	IV-a	14,000	49,000	14,000	4	2%	1,120	64,120	64,120	-
3	S. K.	IV-a	14,000	49,000	14,000	4	2%	1,120	64,120	64,120	-
4	S.T.	IV-a	14,000	49,000	14,000	4	2%	1,120	64,120	64,120	-
5	S. L.	IV-c	10,000	29,500	10,000	3	2%	600	40,100	40,100	-
6	K.J.	III-a/1	14,000	70,500	14,000	12	2%	3,360	87,860	87,860	-
7	L. Sh.	IV-a	14,000	49,000	14,000	25	2%	7,000	70,000	70,000	-
8	E.H.	IV-a	11,000	49,000	11,000	3	2%	660	60,660	60,660	-

Burimi: ADISA përpunuar nga grupi i auditimit

Konkluzioni:

Nga testimet substanciale janë konstatuar se, pozicionet e punës përputhen me kriteret e miratuara nga Këshilli Drejtues, urdhrat e emërimeve dhe nivelin e pagave si dhe klasifikimi në kategoritë e diplomave të nivelit të parë dhe të dytë (bachelor, master profesional dhe shkencor) janë aplikuar sipas kuadrit rregullator ligjor përkatës.

Dokumentacioni i dosjeve në përgjithësi është i plotë ku pjesë përbërëse janë kartat e identitetit, certifikatat familjare, dëftesa/diplomat e nivelit të parë dhe nivelit të dytë të studimeve të larta (në përgjithësi fotokopje të noterizuara), listë notash, vërtetime shëndetësore, certifikata në lidhje me trajnimet dhe gjuhët e huaja, dëshmi penaliteti etj... Nga auditimi me zgjedhje i borderove dhe listë pagesave për muajt e sipërcituar konstatohet se,

Listë prezencat e mbajtura në lidhje me realizimin e ditëve të punës të paguara për punonjësit rakordojnë me listë pagesat dhe me urdhër shpenzimet e thesarit. Aplikimi i pagës për funksion pune dhe pagës së grupit (klasifikimi i diplomës së nivelit të parë dhe të dytë: 14,000 lekë, 11,000 lekë dhe 10,000 lekë) është kryer konform përcaktimeve të VKM-së 187, datë 08.03.2017, bazuar edhe në urdhrat e emërimit të punonjësve apo kontratave individuale të punës.

Për sa i përket auditimit me zgjedhje të 24 dosjeve të personelit, klasifikimi i kategorive së diplomës së nivelit të parë dhe të dytë rakordon me të dhënat e paraqitura në bordero. Përllogaritja e shtesës së vjetërsisë në punë është kryer konform përcaktimeve të VKM-së nr. 187, datë 08.03.2017, konkretisht sipas formulës $\{2\% * \text{pagën e grupit (klasifikimi sipas diplomës së nivelit të dytë master shkencor dhe profesional)} * \text{vitet e punës}\}$ bazuar edhe në vjetërsinë e punës të paraqitur në librezat e punës. Theksojmë se 30% e punonjësve kanë më pak se 1 vit pune, në kushte të tilla referuar VKM sa më sipër nuk përfitojnë nga përllogaritja e kësaj formule.

Nga auditimi u evidentua se listë pagesat janë të plotësuar me të gjitha të dhënat sipas VKM-së së Pagave si, paga kategorisë, paga e grupit vjetërsia për vite pune, si dhe shtesa të tjera të përfituara nga pozicioni i punës.

Listë pagesat janë plotësuar nga punonjësi i caktuar për hartimin e pagave dhe janë nënshkruar nga nëpunësi zbatues dhe nëpunësi autorizues konform kërkesave të përcaktuara në pikën 69, të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik.

Paga shpërblime e të tjera personeli dhe pagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si dhe regjistrimi i tyre në kontabilitet.

Kontabiliteti është i organizuar dhe i mbajtur në zbatim të kërkesave të Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004, për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare në ndryshuar, Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë në ndryshuar, dhe Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të shpallura nga Ministria e Financave. ADISA ka mbajtur në llogaritë e saj aktivet, pasivet dhe transaksionet financiare të rezultuara nga veprimtaria e saj. Mbajtja e evidencës kontabël është kryer në përputhje me ligjin për kontabilitetin dhe Standardet Kontabël. Aktualisht ADISA përdor sistemet e kompjuterizuara për mbajtjen e llogarive kontabël ALPHA (Alpha Platinum) si dhe HRMIS (Human Resource Management Information System) për mbajtjen e pagave. Ditarët evidentohen dhe regjistrohen në mënyrë kronologjike në ALPHA. Regjistrimet kontabël janë të pajisur me evidencë mbështetëse që sigurojnë besueshmërinë e tyre. Regjistrat janë të mbajtur në gjuhën shqipe dhe vlerat në njësitë monetare shqiptare LEKË.

Pasqyrat financiare për vitet ushtrimore 2016, 2017 dhe 2020 të hartuara nga ADISA janë dorëzuar pranë Degës së Thesarit Tiranë si më poshtë:

- Për vitin 2016 me shkresën nr. 196 prot., datë 28.02.2017, brenda afateve ku është marrë miratimi duke u vulosur nga Dega e Thesarit Tiranë.
- Për vitin 2017 me shkresën nr. 202 prot., datë 28.02.2018, brenda afateve ku është marrë miratimi nga Dega e Thesarit Tiranë.
- Për vitin 2020 me shkresën nr. 318 prot., datë 31.03.2021, brenda afateve ku është marrë miratimi nga Dega e Thesarit Tiranë

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

PASIVI (DETYRIMET AFATSHKURTRA)

- Llogaritë e detyrimeve të personelit dhe të tjera detyrime të lidhura me to

Në këtë llogari janë evidentuar detyrimet për paga të personelit dhe detyrimet e tjera të lidhura me to të pagueshme në fund të periudhës ushtrimore si pasojë e pagesave të llogaritura në muajin dhjetor. Në këtë zë të pasqyrave financiare janë paraqitur shpenzimet për detyrime të konstatuara dhe të tjera lidhura me to në kuadër të rakordimit me llogarinë e financimit të pritshëm nga buxheti. Për efekt të hartimit të pasqyrave financiare, këto llogari pasqyrohen në shpenzimet e periudhës ushtrimore, në pasqyrën e shpenzimeve, si paga të konstatuara për aq kohë sa këto detyrime maturohen në mbylljen e vitit. Rrjedhimisht, duke qenë se është njohur si shpenzim i cili nuk është paguar ende, është njohur si detyrim përkatës në pasqyrën financiare.

- Detyrimet e personelit të paraqitura në pasqyrën financiare, i përkasin detyrimeve për pagat e muajit dhjetor të vitit 2016, 2017 dhe 2020 të detajuara si më poshtë:

Tabela nr.4: Gjendja e llogarive në pasqyrat financiare

në lekë				
Numri i llogarisë	Emërtimi i llogarive të pasivit	2016/Lekë	2017/Lekë	2020/Lekë
42	Detyrimet ndaj personelit	4,154,685	6,247,010	7,222,877
431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	346,817	502,429	624,357
435	Sigurime shoqërore	1,275,680	1,909,680	2,122,968
436	Sigurime Shëndetësore	178,656	267,513	296,228
437, 438	Organizma të tjerë shtetëror	169,088	244,341	0

Burimi i të dhënave: Pasqyrat financiare të vitit 2016, 2017 dhe 2020 ADISA

Këto detyrime, janë likuiduar në vitin pasardhës në muajin janar të vitit. Për vitin 2020 nuk ka detyrime të prapambetura ose të papaguara.

□ Llogaria 42 óPersoneli e llogari të lidhura me toó

Llogaria e pagave të konstatuara të vitit paraqitet në lidhje me pagesën e dorëzuar në Tatime në fund të çdo viti.

Tabela nr.5: Shpenzimet faktike për 600, 601

në lekë										
Viti	Paga bruto	Paga sigurime shoqërore për	Sigurime shoqërore		Sigurime shëndetësore		TAP	Sigurim Suplementar	Ndalesa te tjera	Paga neto
			Shoq. PDH	Shoq. PM	Shënd. PDH	Shënd. PM				
Viti 2016	53,316,334	52,499,239	7,874,886	4,987,428	906,378	906,378	482,072	3,621,822	20,303	43,298,332
Viti 2017	87,659,619	86,681,094	13,004,077	8,235,915	1,490,214	1,490,214	5,681,288	2,756,504	25,958	69,469,742
Viti 2020	105,636,124	105,082,596	15,762,389	9,982,847	1,795,814	1,795,814	6,495,060	-	71,979	87,290,424

Burimi i të dhënave: ADISA, Përpunoi Grupi i Auditimit

□ Llogaria 606 óTransferta për buxhetet familjare dhe individëó

Përfshihen të gjitha transferimet e një natyre korrente, të papaguara nga ISSH, ISKSH dhe institucione të tjera qendrore sipas natyrës së specifikuar për përfituesit final.Funksionimi kontabël i kësaj llogarie është si më poshtë:

- ✓ Debitohet 606 óTransferta për buxhetet familjare dhe individëtó;
- ✓ Kreditohet klasa 4, në rastet kur konstatohet detyrimi;
- ✓ Kreditohet llogaria 520 óDisponibilitet në Thesaró ose llogaria 512 ómjete monetare në bankëó kurkonstatohet e paguhet njëkohësisht:

PASQYRA E PERFORMANCËS

SHPENZIMET

Për vitet 2016, 2017 dhe 2020 ADISA ka kryer shpenzime korrente të pasqyruara në pasqyrën e shpenzimeve si burim financimi nga të ardhurat nga Buxheti i Shtetit. ADISA në kushtet si një institucion buxhetor nuk ka financim nga të ardhurat e veta dytësore. Shpenzimet e realizuara për

llogaritë (600, 601) nga buxheti janë të pasqyruara në situacionet e Thesarit që paraqet edhe lëvizjen e fondeve nga llogaria e unifikuar e thesarit për këtë institucion si më poshtë:

Tabela nr.6: Vlerat e buxhetore për 600, 601

në lekë

Viti	Llogaria	Buxheti fillestar	Shtesë/Pakësim Akt normativ nr. 1	Shtesë/Pakësim Akt normativ nr. 2	Rialokim fondi	Buxheti i rishikuar	Fakt	Teprica
2016	600 óPaga personeliô	57,000,000	2,395,000	-	-	59,395,000	51,953,784	7,441,216
	601 óKontributeô	7,600,000	2,586,000	-	-	10,186,000	8,554,211	1,631,789
	TOTALI	64,600,000	4,981,000	-	-	69,581,000	60,507,995	9,073,005
2017	600 óPaga personeliô	101,107,000	-	-	-	101,107,000	85,025,000	16,082,000
	601 óKontributeô	21,673,000	-	-	-	21,673,000	14,063,000	7,610,000
	TOTALI	122,780,000	-	-	-	122,780,000	99,088,000	23,692,000
2020	600 óPaga personeliô	139,541,000	(5,000,000)	(10,000,000)	10,000,000	114,541,000	105,246,420	9,294,580
	601 óKontributeô	18,819,000	-	-	-	18,819,000	17,497,988	1,321,012
	TOTALI	158,360,000	(5,000,000)	(10,000,000)	10,000,000	133,360,000	122,744,408	10,615,592

Burimi i të dhënave: ADISA, Përpunoi Grupi i Auditimit

Referuar tabelës më sipër paraqitet realizimi i fondeve buxhetore për llogaritë (600, 601) për vitet 2016, 2017 dhe 2020, ku rezultojnë një tepricë fondesh në shumën totale për të tre vitet prej 43,380,597 lekë. Kjo diferencë ka ardhur si rezultat i mosplotësimit të strukturës organizative me numrin maksimal të punonjësve. Gjithashtu fondi i miratuar nga Buxheti i Shtetit ka një tolerancë në parashikim pasi llogaritja planifikohet duke përllogaritur të gjithë punonjësit e institucionit të kualifikuar me diplomë të nivelit të dytë (master shkencor) dhe mesatarisht me 10 vite punë. Këto dy komponentë pjesë përbërëse të pagës sjellin diferenca me punonjësit e emëruar realisht sipas strukturës organizative. Në fund të vitit ushtrimor, fondi tepricë nga fondi i pagave dhe kontributeve kthehet në Buxhetin e Shtetit automatikisht nga Dega e Thesarit Tiranë. Këto diferenca janë të pasqyruara në llogarinë óTransferimet në buxhet të fondeve të papërdoruraô së bashku me tepricat e fondeve të llogarive 231 óInvestimet me financim të brendshëmô dhe në llogarinë 602 óShpenzime operativeô sipas pasqyrës së flukseve monetare (chash flow).

- Realizimi i shpenzimeve për llogaritë (600, 601) për vitet 2016, 2017 dhe 2020 sipas listë pagesave, situacioneve të urdhër shpenzimeve të thesarit, deklarimit në sistemin e tatimeve si dhe regjistrimi i tyre në pasqyrat financiare trajtohen në mënyrë të detajuar si më poshtë:

Tabela nr.7: Shpenzimet sipas borderove

në lekë

Muaji	Viti	Sipas sistemit Tatimor		Sipas Degës së Thesarit për llogaritë 600 "Pagat" dhe 601 "Kontributet për Sig. Shoq. dhe Shënd"			Sistemi Tatimor	Dega e Thesarit	Sistemi Tatimor Dega e Thesarit		
		600 "Paga personeli"	601 "Kont. e shoq. dhe shënd."	600 "Paga personeli"	6010 "Kont. Shoq."	6011 "Kont. Shënd."	Diferencë midis Sistemit tatimor dhe Degës së Thesarit		Diferencë midis Degës së Thesarit dhe Pasqyrave Financiare 2016-2017-2020		
							600 "Paga"	601 "Kont. e shoq. dhe shënd."	600 "Paga personeli"	6010 "Kontr. Shoq."	6011 "Kontr. Shënd."
Dhjetor	2015	3,961,123	650,830	3,957,518	583,491	67,339	3,605	0	Sipas pasqyrave financiare për vitin 2016	Sipas pasqyrave financiare për vitin 2016	Sipas pasqyrave financiare për vitin 2016
Janar	2016	4,138,842	680,381	4,135,240	610,021	70,359	3,602	1			
Shkurt	2016	4,128,484	678,610	4,124,878	608,427	70,183	3,606	0			
Mars	2016	4,336,948	713,425	4,332,754	639,697	73,727	4,194	1			
Prill	2016	4,337,380	716,729	4,328,487	642,995	73,734	8,893	0			
Maj	2016	4,303,418	710,482	4,303,423	637,323	73,158	-5	1			
Qershor	2016	4,355,464	710,625	4,355,470	636,582	74,042	-6	1			

Korrik	2016	4,435,792	726,954	4,435,797	651,545	75,409	-5	0			
Gusht	2016	4,264,847	701,888	4,264,851	629,386	72,502	-4	0			
Shtator	2016	4,158,723	686,009	4,145,939	615,312	70,697	12,784	0			
Tetor	2016	4,375,224	720,141	4,388,016	645,761	74,380	-12,792	0			
Nëntor	2016	5,181,411	858,142	5,181,411	770,058	88,083	0	1	53,318,182	10,223,163	1,021,559
Gjobë	2016	0	0	0	0	0	0	0			
Totali		51,977,656	8,554,212	51,953,784	7,670,598	883,613	23,872	1	53,316,334¹	7,874,886	906,378
Diferencë	2016								1,848	1,326,691	115,181
Dhjetor	2016	5,254,569	870,356	5,254,689	781,029	89,327	-120	0	Sipas pasqyrave financiare për vitin 2017	Sipas pasqyrave financiare për vitin 2017	Sipas pasqyrave financiare për vitin 2017
Janar	2017	5,482,964	906,402	5,479,937	813,192	93,209	3,027	1			
Shkurt	2017	5,469,906	904,220	5,469,907	811,233	92,987	-1	0			
Mars	2017	6,550,899	1,079,501	6,553,995	968,128	111,373	-3,096	0			
Prill	2017	6,751,779	1,112,974	6,751,792	998,192	114,782	-13	0			
Maj	2017	7,471,404	1,236,799	7,475,595	1,109,784	127,014	-4,191	1			
Qershor	2017	8,410,823	1,389,599	8,399,648	1,246,614	142,985	11,175	0			
Korrik	2017	8,003,987	1,321,461	7,989,924	1,185,285	136,176	14,063	0			
Gusht	2017	7,909,209	1,309,872	7,909,426	1,175,413	134,458	-217	1			
Shtator	2017	7,842,829	1,298,744	7,842,848	1,165,414	133,330	-19	0			
Tetor	2017	7,882,835	1,305,428	7,882,845	1,171,416	134,012	-10	0	87,659,620	13,179,254	1,755,356
Nëntor	2017	8,014,619	1,327,437	8,014,631	1,191,183	136,253	-12	1			
Gjobë	2017	-	-	-	-	-	0	0			
Totali		85,045,823	14,062,789	85,025,237	12,616,883	1,445,906	20,586	0	87,659,619	13,004,077	1,490,213
Diferencë	2017							0	-	175,177	265,143
Dhjetor	2019	8,363,571	1,389,486	8,342,553	1,247,066	142,186	21,018	234	Sipas pasqyrave financiare për vitin 2020	Sipas pasqyrave financiare për vitin 2020	Sipas pasqyrave financiare për vitin 2020
Janar	2020	8,499,907	1,412,274	8,498,773	1,267,534	144,505	1,134	235			
Shkurt	2020	8,605,785	1,429,954	8,601,585	1,283,415	146,305	4,200	234			
Mars	2020	8,751,106	1,454,162	8,751,330	1,305,153	148,775	-224	234			
Prill	2020	8,694,571	1,445,051	8,694,288	1,297,236	147,815	283	0			
Maj	2020	8,657,393	1,438,798	8,610,231	1,291,618	147,180	47,162	0			
Qershor	2020	8,866,385	1,474,517	8,866,378	1,323,786	150,731	7	0			
Korrik	2020	9,062,307	1,506,418	9,062,304	1,352,356	154,062	3	0			
Gusht	2020	9,060,476	1,506,112	9,060,474	1,352,080	154,032	2	0			
Shtator	2020	9,012,914	1,498,127	9,012,911	1,344,903	153,224	3	0			
Tetor	2020	8,757,682	1,455,611	8,750,477	1,306,730	148,881	7,205	0			
Nëntor	2020	8,955,021	1,488,415	8,952,277	1,336,177	152,238	2,744	0			
Gjobë	2020	-	-	-	-	-			105,685,496	15,762,390	1,795,814
Totali		105,287,118	17,498,923	105,203,581	15,708,054	1,789,934	83,537	935	105,685,494	15,762,389.35	1,795,814
Diferencë	2020								-	-	-

Burimi i të dhënave: ADISA, Përpunoi Grupi i Auditimit

■ Argumentimi i diferencave:

Referuar tabelës më sipër si dhe dokumentacionit të vendosur në dispozicion të grupit të auditimit konstatohen dy lloje diferencash;

a-Diferenca ndërmjet shpenzimeve të realizuara për llogaritë (600, 601) bazuar në situacionet progresive dhe vjetore të Thesarit dhe deklarimeve në sistemin e tatimeve për vlerat 23,872 lekë për vitin 2016, 20,586 lekë për vitin 2017 dhe 83,537 lekë për vitin 2020

b-Diferenca ndërmjet pagave të shpenzuara nga skema e thesarit dhe pasqyrimi në pasqyrat financiare për vlerat:

- 1,848 lekë, 1,326,691 lekë dhe 115,181 lekë për llogaritë përkatëse 600, 6010 dhe 6011 për vitin 2016,

- 175,177 lekë dhe 265,143 lekë për llogaritë përkatëse 6010 dhe 6011 për vitin 2017.

a- Diferenca Sistem Tatimorë – Degë Thesari

Referuar tabelës më sipër si dhe dokumentacionit të vendosur në dispozicion të grupit të auditimit konstatohen diferenca midis shpenzimeve të realizuara për llogaritë (600, 601) bazuar

¹ Janë vlerat e llogaritura për shpenzimet e pagave dhe sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për periudhën Janar-Dhjetor 2016

² Janë vlerat e llogaritura për shpenzimet e pagave dhe sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për periudhën Janar-Dhjetor 2017

³ Janë vlerat e llogaritura për shpenzimet e pagave dhe sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për periudhën Janar-Dhjetor 2020

në situacionet progresive dhe vjetore të Thesarit dhe deklarimeve në sistemin e tatimeve, si më poshtë:

Për vitin 2016:

- Diferencat në muajt Dhjetor 2015 - Mars 2016 janë ndalesa që i janë mbajtur punonjësit z. E. N. për shkak të llogaritjes së pagës me master shkencor, ndërkohë që punonjësi zotëronte diplomë Bachelor. Ndaletat janë mbajtur referuar memo nr. 283 prot., datë 10.09.2015
- Informacion mbi ndryshimin e kategorisë së pagës për Z. E. N. është
- Diferenca prej 4,194 është ndalesë që i është mbajtur Znj. J. D. në muajin mars 2016 si rezultat i llogaritjes gabim dhe dhënies më tepër si pagë e muajit shkurt 2016
- Vlera prej 8,893 lekë është ndalesë që i është mbajtur punonjësës znj. R. K. për efekt të llogaritjes gabim së pagës së muajit Mars 2016. Në muajin mars 2016 i është llogaritur paga sipas kategorisë IV-a, ndërkohë që punonjësja është me kategorinë IV-b
- Diferencat prej +12,784 dhe -12,792 përkatësisht në muajin shtator dhe tetor vijnë si rezultat i pagesës së punonjësve A. B. dhe L. V.j në bordero më vete, ndërkohë sigurimet shoqërore dhe shëndetësore janë mbajtur në të njëjtin muaj në total,

Për vitin 2017:

- Diferencat për muajin Janar dhe Mars 2017 vijnë si rezultat i mbajtjes së sigurimit suplementar gabim. Në janar të 2017 nuk i është mbajtur në vlerë të saktë sigurim suplementar për disa punonjës. Kjo diferencë është mbajtur në muajin Mars 2017.
- Diferenca prej 4191 vjen si rezultat i mosllogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore me kufirin e ri të pagës maksimale. Kjo diferencë i është mbajtur drejtorëve në muajin qershor 2017.
- Diferenca prej 7,000 lekë (11,190-4190=7,000) është ndalesë ndaj punonjësës E.Sh., mbajtur si llogaritje gabim në muajin maj 2017.
- Diferenca e muajit Korrik 2017, janë ndalesa që i janë mbajtur punonjësve mbështetës për të cilët vjetërsia në punë i është llogaritur me 2%, ndërkohë që duhej me 1%, sipas VKM nr. 717, datë 23.6.2009 të Këshillit të Ministrave për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore, të ndryshuar.

Për vitin 2020:

- Diferenca në muajin dhjetor 2019, janar 2020 dhe shkurt 2020 janë ndalesa për telefoni të drejtorëve sipas VKM nr 864, datë 23.07.2010 për pajisjen me numër telefoni celular të funksionarëve publikë.
- Diferenca prej 47,160 lekë është ndalesë që i është mbajtur punonjësës E. C. për pagesë të dhënë më shumë (1 muaj), ndërkohë që punonjësja ishte me leje lindje. Kjo pagë i është mbajtur muajin e parë që ka ardhur nga leja e lindjes.
- Diferenca në muajt tetor dhe nëntor 2020 vjen si rezultat i mbajtjes së vlerës së shpenzimeve të telefonisë sipas VKM nr. 673, datë 2.9.2020 për pajisjen me numër telefoni celular të funksionarëve publikë.

b- Diferenca Pasqyrë Financiare – Degë Thesari

- Lidhur me fondin e pagave të shpenzuara nga skema e thesarit dhe pasqyrimi në pasqyrat financiare, kjo diferencë rezulton nga fakti se në pasqyrat financiare janë të pasqyruara shpenzimet sipas kontabilitetit rrjedhës për pagat e konstatuara nga muaji janar deri në muajin dhjetor, ndërkohë që situacionet e thesarit, janë shprehur në mënyrë progresive shpenzimet për paga nga muaji dhjetor 2015 në muajin nëntor 2016, nga muaji dhjetor 2016 në muajin nëntor 2017 si dhe nga muaji dhjetor 2019 deri nëntor 2020, duke qenë se muaji dhjetor 2016, dhjetor 2017 dhe 2020 del me burim financimit të pritshëm nga buxheti i shtetit.

Referuar të dhënave në tabelën më sipër dhe dokumentacionit të vendosur në dispozicion të grupit të auditimit rezultojnë diferenca midis shifrave të regjistruara në pasqyrat financiare për vitet 2016, 2017 dhe 2020 dhe situacioneve përfundimtare të thesarit në llogarinë 600 óPaga personeliô si dhe llogarinë 601 óKontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësoreô. Me veprimet rregulluese të mësipërme totali i ri-llogaritur nga grupi i auditimit nuk rakordon me shpenzimet e pasqyrës së performancës konkretisht si më poshtë:

Për vitin 2016: Në pasqyrat financiare është regjistruar shuma 53,318,182 lekë në llogarinë (600). Në këtë llogari të bilancit ka një diferencë pozitive prej 1,441,872 lekë për arsye se:

- Në llogarinë 6010 kemi një vlerë prej 305,132 lekë që i përket shpenzimeve për sigurime shoqërore për PMU-në. Ky regjistrim kontabël, në auditimin paraardhës të KLSH është lënë rekomandim të sistemohet dhe regjistrohet në llogarinë kontabël 202. Ky sistemim është kryer në PF 2020. Gjithashtu, është një diferencë prej 1,021,559 lekë hedhur gabimisht në excelin e PF 2016. Vlera totale e llogarisë 601 është vendosur gabimisht në llogarinë 6010. Në programin Alpha, vlera në bilanc është e saktë.

- Në llogarinë 6011 kemi një vlerë prej 115,181 lekë që i përket shpenzimeve për sigurime shëndetësore për PMU-në. Edhe kjo llogari është sistemuar në PF 2020.

Për vitin 2017: Në pasqyrat financiare është regjistruar shuma 87,659,620 lekë në llogarinë (600). Në llogarinë 601 të bilancit ka një diferencë pozitive prej 440,320 lekë për arsye se:

- Në llogarinë 6010 kemi një vlerë prej 175,177 lekë që i përket shpenzimeve për sigurime shoqërore për PMU-në. Ky regjistrim kontabël, në auditimin paraardhës të KLSH është lënë rekomandim të sistemohet dhe regjistrohet në llogarinë kontabël 202. Ky sistemim është kryer në PF 2020.

- Në llogarinë 6011 kemi një vlerë prej 265,143 lekë që i përket shpenzimeve për sigurime shëndetësore për PMU-në. Edhe kjo llogari është sistemuar në PF 2020.

• **Raportimi i shpenzimeve të ligjshme të programit EEP për llogaritë (600, 601) të cilat mbulohen me financim nga Projekti “Ofrimi i shërbimeve publike me në qendër qytetarin”.**

Bazuar në Manualin Operacional të Projektit (POM) shpenzimet të ligjshme që do të mbulohen nga projekti janë pagat dhe kontributi për sigurime shoqërore për Institucione Buxhetore dhe Jobuxhetore.

- Për Institucionet Buxhetore shpenzimet e ligjshme janë pagat dhe kontributet shoqërore për:

- ✓ Zyrat e Gjendjes Civile në 61 bashki të Ministrisë së Brendshme.

- ✓ Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit-AKSHI.

- ✓ Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara-ADISA

- Për Institucionet Jobuxhetore shpenzimet e ligjshme janë pagat dhe kontributet shoqërore për:

- ✓ Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (sot Agjencia Shtetërore e Kadastrës).

Në zbatim të angazhimeve të Marrëveshjes së Huas të ratifikuar me Ligjin nr. 3/2016, datë 28.01.2016, për Projektin óOfrimi i shërbimeve publike me në qendër qytetarinô, Njësia e Menaxhimit të Projektit (PMU) ka përgatitur raportimet financiare (IFR) të cilat i ka dërguar pranë EBRD për vitet 2016, 2017 dhe 2020, në lidhje me shpenzimet e ligjshme sipas programit (EEP) për llogaritë (600, 601) që mbulohen nga Projekti për institucionet e sipërcituara.

Për vitin 2020

Raportimi financiar (IFR) ka detyrimin të paraqitet nga PMU pranë EBRD cdo tremujor të vitit, në nivel makro të llogarive 600 dhe 601. Të dhënat e raportimit, të cilat paraqiten në tabelat e mëposhtme, janë testuar duke i krahasuar ato me shpenzimet e pagave dhe kontributeve të nxjerra nga databaza e degës së thesarit nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për katër institucionet e sipërcituara, pjesë të marrëveshjes së huasë (ZGJC, AKSHI, ASHK dhe ASHK). Më poshtë po paraqesim raportimet IFRs dhe testimet për vitin 2020.

Tabela nr.8: Krahasim i vlerave të raportuara me faktike

në '000 lekë								
Institucioni	Kodet e Instit	Kodi Programit	Emri i Programit	Llogaria ekonomike	Shpenzimet Aktuale	Shpenzimet Aktuale Rritëse YTD	Buxheti YTD	Variancat
Ministria e Brendshme	16/ Kodet e Bashkive	1170	Regjistri i Gjendjes Civile	600 Pagat	83,067.75	83,067.75	87,671.75	4,604.00
				601 Kontributet për Sigurimet	13,650.64	13,650.64	14,638.25	987.61
AKSHI	87/1087006	1140	Shërbimet e Shoqërisë së Informacionit	600 Pagat	67,102.99	67,102.99	85,954.00	18,851.01
				601 Kontributet për Sigurimet	11,024.86	11,024.86	15,353.75	4,328.89
ADISA	87/1087017	1160	Shërbimet e Përgjithshme Publike	600 Pagat	25,447.05	25,447.05	34,885.25	9,438.20
				601 Kontributet për Sigurimet	4,231.01	4,231.01	4,704.75	473.74
ASHK	N/A	N/A	N/A	600 Pagat	224,302.34	224,302.34	224,302.34	-
				601 Kontributet për Sigurimet	52,280.40	52,280.40	52,280.40	-
Totali					481,107.04	481,107.04	519,790.49	38,683.45

në '000 lekë								
Institucioni	Kodet e Instit	Kodi Programit	Emri i Programit	Llogaria ekonomike	Shpenzimet Aktuale	Shpenzimet Aktuale Rritëse YTD	Buxheti YTD	Variancat
Ministria e Brendshme	16/ Kodet e Bashkive	1170	Regjistri i Gjendjes Civile	600 Pagat	83,782.20	166,849.95	175,343.50	8,493.55
				601 Kontributet për Sigurimet	13,709.96	27,360.60	29,276.50	1,915.90
AKSHI	87/1087006	1140	Shërbimet e Shoqërisë së Informacionit	600 Pagat	69,921.60	137,024.50	164,408.00	27,383.50
				601 Kontributet për Sigurimet	11,518.14	22,543.34	28,707.50	6,164.16
ADISA	87/1087017	1160	Shërbimet e Përgjithshme Publike	600 Pagat	26,055.85	51,502.90	67,270.50	15,767.60
				601 Kontributet për Sigurimet	4,337.77	8,568.78	9,409.50	840.72
ASHK	N/A	N/A	N/A	600 Pagat	319,094.03	543,396.37	543,396.37	-
				601 Kontributet për Sigurimet	53,249.20	105,529.60	105,529.60	-
Totali					581,668.75	1,062,776.04	1,123,341.47	60,565.43

në '000 lekë								
Institucioni	Kodet e Institucioneve	Kodi Programit	Emri i Programit	Llogaria ekonomike	Shpenzimet Aktuale	Shpenzimet Aktuale Rritëse	Buxheti YTD	Variancat
Ministria e Brendshme	16/ Kodet e Bashkive	1170	Regjistri i Gjendjes Civile	600 Pagat	84,144.00	250,993.00	263,015.25	12,022.25
				601 Kontributet për Sigurimet	14,165.00	41,525.00	43,914.75	2,389.75
AKSHI	87/1087006	1140	Shërbimet e Shoqërisë së Informacionit	600 Pagat	72,023.00	209,047.00	246,612.00	37,565.00
				601 Kontributet për Sigurimet	11,798.00	34,341.60	43,061.25	8,719.65
ADISA	87/1087017	1160	Shërbimet e Përgjithshme Publike	600 Pagat	27,008.00	78,511.00	100,905.75	22,394.75
				601 Kontributet për Sigurimet	4,487.00	13,056.00	14,114.25	1,058.25
ASHK	N/A	N/A	N/A	600 Pagat	332,591.00	875,987.37	875,987.37	-
				601 Kontributet për Sigurimet	50,639.00	156,168.60	156,168.60	-
Totali					596,855.00	1,659,629.57	1,743,779.22	84,149.65

në '000 lekë								
--------------	--	--	--	--	--	--	--	--

Institucioni	Kodet e Institucioneve	Kodi Programit	Emri i Programit	Llogaria ekonomike	Shpenzimet Aktuale	Shpenzimet Aktuale Rritëse YTD	Buxheti YTD	Variancat
Ministria e Brendshme	16/ Kodet e Bashkive	1170	Regjistri i Gjendjes Civile	600 Pagat	84,473.00	335,466.00	345,687.00	10,221.00
				601 Kontributet për Sigurimet	14,035.00	55,560.00	58,553.00	2,993.00
AKSHI	87/1087006	1140	Shërbimet e Shoqërisë së Informacionit	600 Pagat	69,996.00	279,043.00	308,816.00	29,773.00
				601 Kontributet për Sigurimet	11,621.00	45,963.00	52,415.00	6,452.00
ADISA	87/1087017	1160	Shërbimet e Përgjithsme Publike	600 Pagat	26,735.00	105,246.00	114,541.00	9,295.00
				601 Kontributet për Sigurimet	4,442.00	17,498.00	18,819.00	1,321.00
ASHK	N/A	N/A	N/A	600 Pagat	394,797.00	938,193.37	938,193.37	-
				601 Kontributet për Sigurimet	54,420.00	159,950.00	159,950.00	-
				Totali	660,519.00	1,936,919.37	1,996,974.37	60,055.00

Burimi i të dhënave: PMU, përpunuar nga Grupi Auditimit

Nga databaza e Thesarit të DPTH pjesë e MFE-së, janë nxjerrë shpenzimet e pagave dhe të kontributeve (600 dhe 601), të cilat mbulohen nga marrëveshja e huasë (IBRD Loan 8521 në AL) nëpërmjet Programit 1330 ó Menaxhimi dhe Zhvillimi i Administratës Publike në sistemin SIFQ. Këto shpenzime janë nxjerrë dhe krahasuar me IFRs në nivel vjetor dhe nivel trimestri si më poshtë;

- Në nivel vjetor

Tabela nr.9: Krahasim i vlerave të raportuara me faktike

ADISA

Programi 1160(1330) Menaxhimi dhe Zhvillimi i Administratës Publike

në lekë

Llogaria ekonomike	Përshkrimi llogarisë	DPTH viti 2020	IFRs Report YTD 2020	Diferenca
		Shpenzime nga Thesari	Shpenzime Rritese YTD 2020	
6001001	Paga baze	77,906,584	Shpenzime të ligjshme (EEP) të raportuara nga PMU pranë EBRD për vitin financiar 2020 (llogaria 600 Paga dhe përfitime të punonjësve)	
6001002	Raporte mjeksore te paguara nga punedhenesi	446,006		
6001003	Shtese page per vjetërsi ne pune	2,400,023		
6001008	Shtese page per kualifikimin	240,000		
6001020	Shtesë page për diferencë në rastet kur paga e muajit/ve paraardhës është llogaritur më pak	162,922		
6001021	Paga e grupit	22,918,841		
6002100	Paga me kontrate per kohe te kufizuar	1,152,655		
6003900	Te tjera shperblime per personelin	19,389		
Total 600		105,246,420	105,246,420	-
6010100	Kontribute per sigurime shoqerore	15,708,054	Shpenzime të ligjshme (EEP) të raportuara nga PMU pranë EBRD për vitin financiar 2020 (llogaria 601 Kontribute të Sigurimeve)	
6011100	Kontribute per sigurime shendetesore	1,789,934		
Total 601		17,497,988	17,497,988	-
Total		122,744,408	122,744,408	-

Burimi i të dhënave: Grupi i Auditimit nga DPTH

- Në nivel trimestri (tremujor)

Tabela nr.10: Krahasim i vlerave të raportuara me faktike

në lekë

ADISA

Programi 1160(1330) Menaxhimi dhe Zhvillimi i Administratës Publike

Tremujori	Llogaria Makro	Llogaria ekonomike	Përshkrimi llogarisë	DPTH viti 2020	IFRs Report YTD 2020	Diferenca
Trimestri I	600	6001001	Paga baze	19,131,731	Shpenzime të ligjshme (EEP) të raportuara nga PMU pranë EBRD për trimestrin I 2020 (llogaria 600 Paga dhe përfitime të	
		6001002	Raporte mjeksore te paguara nga punedhenesi	147,342		
		6001003	Shtese page per vjetërsi ne pune	647,331		
		6001008	Shtese page per kualifikimin	60,000		

		6001021	Paga e grupit	5,093,545	<i>punonjësve)</i>	
		6002100	Paga me kontrate per kohe te kufizuar	367,104		
	Total 600			25,447,053	25,447,053	
	601	6010100	Kontribute per sigurime shoqerore	3,798,015	<i>Shpenzime të ligjshme (EEP) të raportuara nga PMU pranë EBRD për trimestrin I 2020 (llogaria 601 Kontribute të Sigurimeve)</i>	-
		6011100	Kontribute per sigurime shendetesore	432,996		
	Total 601			4,231,011	4,231,011	
Trimestri II	600	6001001	Paga baze	17,696,145	<i>Shpenzime të ligjshme (EEP) të raportuara nga PMU pranë EBRD për trimestrin II 2020 (llogaria 600 Paga dhe përfitime të punonjësve)</i>	-
		6001003	Shtese page per vjetersi ne pune	527,484		
		6001008	Shtese page per kualifikimin	60,000		
		6001021	Paga e grupit	7,405,116		
		6002100	Paga me kontrate per kohe te kufizuar	367,104		
	Total 600			26,055,849	26,055,849	
	601	6010100	Kontribute per sigurime shoqerore	3,894,007	<i>Shpenzime të ligjshme (EEP) të raportuara nga PMU pranë EBRD për trimestrin II 2020 (llogaria 601 Kontribute të Sigurimeve)</i>	-
		6011100	Kontribute per sigurime shendetesore	443,770		
	Total 601			4,337,777	4,337,777	
Trimestri III	600	6001001	Paga baze	20,823,432	<i>Shpenzime të ligjshme (EEP) të raportuara nga PMU pranë EBRD për trimestrin III 2020 (llogaria 600 Paga dhe përfitime të punonjësve)</i>	-
		6001002	Raporte mjeksore te paguara nga punedhenesi	75,790		
		6001003	Shtese page per vjetersi ne pune	644,782		
		6001008	Shtese page per kualifikimin	60,000		
		6001021	Paga e grupit	5,162,953		
		6002100	Paga me kontrate per kohe te kufizuar	222,199		
		6003900	Te tjera shperblime per personelin	19,389		
	Total 600			27,008,545	27,008,545	
	601	6010100	Kontribute per sigurime shoqerore	4,028,222	<i>Shpenzime të ligjshme (EEP) të raportuara nga PMU pranë EBRD për trimestrin III 2020 (llogaria 601 Kontribute të Sigurimeve)</i>	-
		6011100	Kontribute per sigurime shendetesore	458,825		
	Total 601			4,487,047	4,487,047	
Trimestri IV	600	6001001	Paga baze	20,255,276	<i>Shpenzime të ligjshme (EEP) të raportuara nga PMU pranë EBRD për trimestrin IV 2020 (llogaria 600 Paga dhe përfitime të punonjësve)</i>	-
		6001002	Raporte mjeksore te paguara nga punedhenesi	222,874		
		6001003	Shtese page per vjetersi ne pune	580,426		
		6001008	Shtese page per kualifikimin	60,000		
		6001020	Shtesë page për diferencë në rastet kur paga e muajit/ve paraardhës është llogaritur më pak	162,922		
		6001021	Paga e grupit	5,257,227		
		6002100	Paga me kontrate per kohe te kufizuar	196,248		
	Total 600			26,734,973	26,734,973	
	601	6010100	Kontribute per sigurime shoqerore	3,987,810	<i>Shpenzime të ligjshme (EEP) të raportuara nga PMU pranë EBRD për trimestrin IV 2020 (llogaria 601 Kontribute të Sigurimeve)</i>	-
		6011100	Kontribute per sigurime shendetesore	454,343		
	Total 601			4,442,153	4,442,153	

Burimi i të dhënave: Grupi i Auditimit nga DPTH

Nga ky testim si dhe bazuar në dokumentacionin e vendosur në dispozicion të grupit të auditimit rezulton se, shpenzimet e ligjshme sipas programit (EEP) për llogaritë (600, 601) të realizuara për vitin 2020 nga ADISA, bazuar në listë pagesat, urdhër shpenzimet e thesarit dhe deklarimeve

në sistemin e tatimeve, si në nivel vjetor dhe në nivel tremujori, rakordojnë me të dhënat e raportuara nga PMU pranë EBRD-së.

Për vitin 2017

Raportimi financiar (IFRs) nga PMU pranë EBRD çdo tremujor të vitit 2017, në nivel makro të llogarive 600 dhe 601, paraqitet si më poshtë;

Tabela nr.11: Krahësim i vlerave të raportuara me faktike

IRFs për vitin 2017

në '000 lekë

Institucioni	Kodet e Institucioneve	Kodi Programit	Emri i Programit	Llogaria ekonomike	Shpenzimet Aktuale	Shpenzimet Aktuale Rritëse YTD	Buxheti YTD	Variancat
Ministria e Brendshme	16/ Kodet e Bashkive	1170	Regjistri i Gjendjes Civile	600 Pagat	76,960.00	76,960.00	74,171.00	(2,789.00)
				601 Kontributet për Sigurimet	12,518.00	12,518.00	13,639.00	1,121.00
AKSHI	87/1087006	1140	Shërbimet e Shoqërisë së Informacionit	600 Pagat	20,227.00	20,227.00	28,690.00	8,463.00
				601 Kontributet për Sigurimet	3,231.00	3,231.00	4,758.75	1,527.75
ADISA	87/1087017	1160	Shërbimet e Përgjithsme Publike	600 Pagat	16,204.00	16,204.00	25,276.75	9,072.75
				601 Kontributet për Sigurimet	2,680.00	2,680.00	5,418.25	2,738.25
ASHK	N/A	N/A	N/A	600 Pagat	123,265.00	123,265.00	123,265.00	-
				601 Kontributet për Sigurimet	22,670.00	22,670.00	22,670.00	-
				Totali	277,755.00	277,755.00	297,888.75	20,133.75

në '000 lekë

Institucionit	Kodet e Institucioneve	Kodi Programit	Emri i Programit	Llogaria ekonomike	Shpenzimet Aktuale Rritëse	Shpenzimet Aktuale Rritëse	Buxheti YTD	Variancat
Ministria e Brendshme	16/ Kodet e Bashkive	1170	Regjistri i Gjendjes Civile	600 Pagat	82,161.00	159,212.00	172,461.50	13,249.50
				601 Kontributet për Sigurimet	13,796.00	26,316.00	29,166.50	2,850.50
AKSHI	87/1087006	1140	Shërbimet e Shoqërisë së Informacionit	600 Pagat	21,670.00	41,897.00	57,380.00	15,483.00
				601 Kontributet për Sigurimet	3,364.00	6,595.00	9,517.50	2,922.50
ADISA	87/1087017	1160	Shërbimet e Përgjithshme Publike	600 Pagat	20,781.00	36,985.00	50,553.50	13,568.50
				601 Kontributet për Sigurimet	3,430.00	6,110.00	10,836.50	4,726.50
ASHK	N/A	N/A	N/A	600 Pagat	146,294.00	269,559.00	269,559.00	-
				601 Kontributet për Sigurimet	24,168.00	46,838.00	46,838.00	-
				Totali	315,664.00	593,512.00	646,312.50	52,800.50

në '000 lekë

Institucioni	Kodet e Institucioneve	Kodi Programit	Emri i Programit	Llogaria ekonomike	Shpenzimet Aktuale Rritëse	Shpenzimet Aktuale Rritëse YTD	Buxheti YTD	Variancat
Ministria e Brendshme	16/ Kodet e Bashkive	1170	Regjistri i Gjendjes Civile	600 Pagat	80,769.00	239,981.00	258,692.25	18,711.25
				601 Kontributet për Sigurimet	13,908.00	40,224.00	43,749.75	3,525.75
AKSHI	87/1087006	1140	Shërbimet e Shoqërisë së Informacionit	600 Pagat	21,203.00	63,100.00	86,070.00	22,970.00
				601 Kontributet për Sigurimet	3,430.00	10,025.00	14,276.00	4,251.00
ADISA	87/1087017	1160	Shërbimet e	600 Pagat	24,299.00	61,284.00	75,830.25	14,546.25

			Përgjithshme Publike	601 Kontributet për Sigurimet	4,021.00	10,131.00	16,254.75	6,123.75
ASHK	N/A	N/A	N/A	600 Pagat	143,562.00	413,121.00	413,121.00	-
				601 Kontributet për Sigurimet	25,336.00	72,174.00	72,174.00	-
				Totali	316,528.00	910,040.00	980,168.00	70,128.00

në '000 lekë

Institucioni	Kodet e Institucioneve	Kodi Programit	Emri i Programit	Llogaria ekonomike	Shpenzimet Aktuale	Shpenzimet Aktuale Rritëse YTD	Buxheti YTD	Variancat
Ministria e Brendshme	16/ Kodet e Bashkive	1170	Regjistri i Gjendjes Civile	600 Pagat	86,492.00	326,473.00	344,923.00	18,450.00
				601 Kontributet për Sigurimet	14,047.00	54,271.00	58,333.00	4,062.00
AKSHI	87/1087006	1140	Shërbimet e Shoqërisë së Informacionit	600 Pagat	21,368.00	84,468.00	114,741.00	30,273.00
				601 Kontributet për Sigurimet	3,444.00	13,469.00	19,035.00	5,566.00
ADISA	87/1087017	1160	Shërbimet e Përgjithshme Publike	600 Pagat	23,740.00	85,024.00	101,106.00	16,082.00
				601 Kontributet për Sigurimet	3,931.00	14,062.00	21,672.00	7,610.00
ASHK	N/A	N/A	N/A	600 Pagat	153,395.00	566,516.00	566,516.00	-
				601 Kontributet për Sigurimet	21,925.00	94,099.00	94,099.00	-
				Totali	328,342.00	1,238,382.00	1,320,425.00	82,043.00

Burimi i të dhënave: PMU, përpunuar nga Grupi Auditimit

Nga databaza e Thesarit të DPTH pjesë e MFE-së, janë nxjerrë shpenzimet e pagave dhe të kontributeve (600 dhe 601), të cilat mbulohen nga marrëveshja e huasë (IBRD Loan 8521 në AL) nëpërmjet Programit 1330 ó Menaxhimi dhe Zhvillimi i Administratës Publike në sistemin SIFQ. Këto shpenzime janë nxjerrë dhe krahasuar me IFRs në nivel vjetor dhe nivel trimestri si më poshtë;

- Në nivel vjetor

Tabela nr.12: Krahasim i vlerave të raportuara me faktike

ADISA

Programi 1160(1330) Menaxhimi dhe Zhvillimi i Administratës

Publike

në lekë

Llogaria ekonomike	Përshkrimi i llogarisë	DPTH viti 2017	IFRs Report YTD 2017	Diferenca
		Shpenzime nga Thesari	Shpenzime Rritëse YTD 2017	
6001001	Paga baze	64,397,487	Shpenzime të ligjshme (EEP) të raportuara nga PMU pranë EBRD për vitin financiar 2017 (llogaria 600 Paga dhe përfitime të punonjësve)	
6001002	Raporte mjeksore të paguara nga punedhësi	3,169,609		
6001003	Shtese page për vjetërsi në punë	1,278,890		
6001005	Shtese page për funksionin	16,179,251		
Total 600		85,025,237	85,025,237	-
6010100	Kontribute për sigurime shoqërore	10,738,993	Shpenzime të ligjshme (EEP) të raportuara nga PMU pranë EBRD për vitin financiar 2017 (llogaria 601 Kontribute të Sigurimeve)	
6011100	Kontribute për sigurime shëndetësore	3,323,796		
Total 601		14,062,789	14,062,789	-

Burimi i të dhënave: Grupi i Auditimit nga DPTH

- Në nivel trimestri (tremujor)

Tabela nr.13: Krahasim i vlerave të raportuara me faktike

ADISA

Programi 1160(1330) Menaxhimi dhe Zhvillimi i Administrates Publike				DPTH viti 2017	IFRs Report YTD 2017	Diferenca
Tremujori	Llogaria Makro	Llogaria ekonomike	Përshkrimi llogarisë	Shpenzime nga Thesari	Shpenzime Rritese YTD 2017	
Trimestri I	600	6001001	Paga baze	11,144,539	Shpenzime të ligjshme (EEP) të raportuara nga PMU pranë EBRD për trimestrin I 2017 (llogaria 600 Paga dhe përfitime të punonjësve)	-
		6001002	Raporte mjeksore te paguara nga punedhenesi	1,899,358		
		6001003	Shtese page per vjetersi ne pune	260,036		
		6001005	Shtese page per funksionin	2,900,600		
	Total 600			16,204,533	16,204,533	
	601	6010100	Kontribute per sigurime shoqerore		Shpenzime të ligjshme (EEP) të raportuara nga PMU pranë EBRD për trimestrin I 2017 (llogaria 601 Kontribute të Sigurimeve)	-
				2,680,977		
Total 601			2,680,977	2,680,977		
Trimestri II	600	6001001	Paga baze	16,324,746	Shpenzime të ligjshme (EEP) të raportuara nga PMU pranë EBRD për trimestrin II 2017 (llogaria 600 Paga dhe përfitime të punonjësve)	-
		6001002	Raporte mjeksore te paguara nga punedhenesi	405,317		
		6001003	Shtese page per vjetersi ne pune	299,338		
		6001005	Shtese page per funksionin	3,751,981		
	Total 600			20,781,382	20,781,382	
	601	6010100	Kontribute per sigurime shoqerore	2,107,976	Shpenzime të ligjshme (EEP) të raportuara nga PMU pranë EBRD për trimestrin II 2017 (llogaria 601 Kontribute të Sigurimeve)	-
		6011100	Kontribute per sigurime shendetesore	1,321,297		
Total 601			3,429,273	3,429,273		
Trimestri III	600	6001001	Paga baze	18,515,361	Shpenzime të ligjshme (EEP) të raportuara nga PMU pranë EBRD për trimestrin III 2017 (llogaria 600 Paga dhe përfitime të punonjësve)	-
		6001002	Raporte mjeksore te paguara nga punedhenesi	697,055		
		6001003	Shtese page per vjetersi ne pune	344,799		
		6001005	Shtese page per funksionin	4,741,783		
	Total 600			24,298,998	24,298,998	
	601	6010100	Kontribute per sigurime shoqerore	2,422,027	Shpenzime të ligjshme (EEP) të raportuara nga PMU pranë EBRD për trimestrin III 2017 (llogaria 601 Kontribute të Sigurimeve)	-
		6011100	Kontribute per sigurime shendetesore	1,598,904		
Total 601			4,020,931	4,020,931		
Trimestri IV	600	6001001	Paga baze	18,412,841	Shpenzime të ligjshme (EEP) të raportuara nga PMU pranë EBRD për trimestrin IV 2017 (llogaria 600 Paga dhe përfitime të punonjësve)	-
		6001002	Raporte mjeksore te paguara nga punedhenesi	167,879		
		6001003	Shtese page per vjetersi ne pune	374,717		
		6001005	Shtese page per funksionin	4,784,887		
	Total 600			23,740,324	23,740,324	
	601	6010100	Kontribute per sigurime shoqerore	3,528,013	Shpenzime të ligjshme (EEP) të raportuara nga PMU pranë EBRD për trimestrin IV 2017 (llogaria 601 Kontribute të Sigurimeve)	-
		6011100	Kontribute per sigurime shendetesore	403,595		
Total 601			3,931,608	3,931,608		

Burimi i të dhënave: Grupi i Auditimit nga DPTH

Nga ky testim si dhe bazuar në dokumentacionin e vendosur në dispozicion të grupit të auditimit rezultojnë se, shpenzimet e ligjshme sipas programit (EEP) për llogaritë (600, 601) të realizuara për vitin 2017 nga ADISA, bazuar në listë pagesat, urdhër shpenzimet e thesarit dhe deklarimeve në sistemin e tatimeve, si në nivel vjetor dhe në nivel tremujor, rakordojnë me të dhënat e raportuara nga PMU pranë EBRD-së.

Për vitin 2016

Raportimi financiar (IFRs) nga PMU pranë EBRD cdo tremujor të vitit 2016, në nivel makro të llogarive 600 dhe 601, paraqitet si më poshtë;

Tabela nr.14: Krahasim i vlerave të raportuara me faktike*IFRs per vitin 2016**në '000 lekë*

Institucion	Kodet e Institucioneve	Kodi Programit	Emri i Programit	Llogaria ekonomike	Shpenzimet Aktuale Rritëse	Shpenzimet Aktuale Rritëse YTD	Buxheti YTD	Variancat
Ministria e Brendshme	16/ Kodet e Bashkive	1170	Regjistri i Gjendjes Civile	600 Pagat	76,164.00	152,329.00	163,342.00	11,013.00
				601 Kontributet për Sigurimet	12,150.00	25,382.00	27,278.00	1,896.00
AKSHI	87/1087006	1140	Shërbimet e Shoqërisë së Informacionit	600 Pagat	18,833.00	37,666.00	58,687.00	21,021.00
				601 Kontributet për Sigurimet	2,985.00	5,970.00	8,750.00	2,780.00
ADISA	87/1087017	1160	Shërbimet e Përgjithsme Publike	600 Pagat	12,746.00	25,492.00	45,000.00	19,508.00
				601 Kontributet për Sigurimet	2,096.00	4,192.00	3,500.00	(692.00)
ASHK	N/A	N/A	N/A	600 Pagat	111,184.00	222,368.00	222,368.00	-
				601 Kontributet për Sigurimet	21,339.00	42,678.00	42,678.00	-
				Totali	257,497.00	516,077.00	571,603.00	55,526.00

në '000 lekë

Institucion	Kodet e Institucioneve	Kodi Programit	Emri i Programit	Llogaria ekonomike	Shpenzimet Aktuale Rritëse	Shpenzimet Aktuale Rritëse YTD	Buxheti YTD	Variancat
Ministria e Brendshme	16/ Kodet e Bashkive	1170	Regjistri i Gjendjes Civile	600 Pagat	76,164.00	228,493.00	245,013.00	16,520.00
				601 Kontributet për Sigurimet	12,150.00	37,532.00	40,917.00	3,385.00
AKSHI	87/1087006	1140	Shërbimet e Shoqërisë së Informacionit	600 Pagat	18,834.00	56,500.00	88,031.00	31,531.00
				601 Kontributet për Sigurimet	2,895.00	8,865.00	13,125.00	4,260.00
ADISA	87/1087017	1160	Shërbimet e Përgjithsme Publike	600 Pagat	12,746.00	38,238.00	44,546.00	6,308.00
				601 Kontributet për Sigurimet	2,097.00	6,289.00	7,639.00	1,350.00
ASHK	N/A	N/A	N/A	600 Pagat	154,221.00	376,589.00	376,589.00	-
				601 Kontributet për Sigurimet	22,802.00	65,480.00	65,480.00	-
				Totali	301,909.00	817,986.00	881,340.00	63,354.00

në '000 lekë

Institucioni	Kodet e Institucioneve	Kodi Programit	Emri i Programit	Llogaria ekonomike	Shpenzimet Aktuale Rritëse	Shpenzimet Aktuale Rritëse YTD	Buxheti YTD	Variancat
--------------	------------------------	----------------	------------------	--------------------	----------------------------	--------------------------------	-------------	-----------

Ministria e Brendshme	16/ Kodet e Bashkive	1170	Regjistri i Gjendjes Civile	600 Pagat	78,526.00	307,019.00	324,334.00	17,315.00
				601 Kontributet për Sigurimet	12,612.00	50,144.00	54,156.00	4,012.00
AKSHI	87/1087006	1140	Shërbimet e Shoqërisë së Informacionit	600 Pagat	15,568.00	75,068.00	87,055.00	11,987.00
				601 Kontributet për Sigurimet	3,035.00	11,900.00	14,200.00	2,300.00
ADISA	87/1087017	1160	Shërbimet e Përgjithsme Publike	600 Pagat	13,715.00	51,953.00	54,795.00	2,842.00
				601 Kontributet për Sigurimet	2,265.00	8,554.00	10,186.00	1,632.00
ASHK	N/A	N/A	N/A	600 Pagat	152,976.00	529,565.00	529,565.00	-
				601 Kontributet për Sigurimet	23,003.00	88,483.00	88,483.00	-
				Totali	301,700.00	1,122,686.00	1,162,774.00	40,088.00

Burimi: Grupi i auditimit

Nga databaza e Thesarit të DPTH pjesë e MFE-së, janë nxjerrë shpenzimet e pagave dhe të kontributeve (600 dhe 601), të cilat mbulohen nga marrëveshja e huasë (IBRD Loan 8521 në AL) nëpërmjet Programit 1330 ó Menaxhimi dhe Zhvillimi i Administratës Publike në sistemin SIFQ. Këto shpenzime janë nxjerrë dhe krahasuar me IFRs në nivel vjetor dhe nivel trimestri si më poshtë;

- Në nivel vjetor

Tabela nr.15: Krahasim i vlerave të raportuara me faktike

në lekë

ADISA

Programi 1160(1330) Menaxhimi dhe Zhvillimi i Administratës Publike

Llogaria ekonomike	Përshkrimi llogarisë	DPTH viti 2016	DPTH 2016 Shkresa nr.prot 492 date 30.01.2017	IFRs Report YTD 2016	Diferenca
		Shpenzime nga Thesari		Shpenzime Rritesë YTD 2016	
6001001	Paga baze	36,443,213		Shpenzime të ligjshme (EEP) të raportuara nga PMU pranë EBRD për vitin financiar 2016 (llogaria 600 Paga dhe përfitime të punonjësve)	-
6001002	Raporte mjeksore të paguara nga punedhenesi	622,929			
6001003	Shtese page për vjetërsi në punë	1,292,602			
6001005	Shtese page për funksionin	8,477,616			
Total 600		46,836,360	51,953,784	51,953,784	-
6010100	Kontribute për sigurime shoqërore	7,130,163	8,554,211	Shpenzime të ligjshme (EEP) të raportuara nga PMU pranë EBRD për vitin financiar 2016 (llogaria 601 Kontribute të punonjësve)	-
Total 601		7,130,163		8,554,211	

Burimi: DPTH përpunuar nga Grupi i Auditimit

Duhet thënë se gjatë ekstraktimit të databazave të thesarit, muaji prill 2016 nuk kishte asnjë të dhënë apo transaksion të regjistruar në lidhje me shpenzimet e pagave (600) si dhe të kontributeve të sigurimeve (601). Për këtë arsye i kemi referuar komunikimit që ka pasur ADISA me Drejtorinë e Operacioneve të Thesarit, ku kjo e fundit i ka nisur shkresën me nr.prot, 492/1 datë 30.01.2017 ku i kthen përgjigje ADISA-s në lidhje me transaksionet e thesarit për tre institucionet (AKSHI, ADISA dhe Gjendja Civile) referuar shpenzimeve të pagave dhe kontributeve si më poshtë;

Tabela nr.16: Krahasim i vlerave të raportuara me faktike

në lekë

	Plan	Fakt	Fonde
<i>Agjensia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit</i>			
600 Paga shpërblime dhe të tjera	87,055,000	75,068,637	11,986,363
601 Kontribute për Sigurime shoqërore	14,200,000	11,900,007	2,299,993
<i>Ministria e Punëve të Brendshme (Gjendja Civile</i>			
600 Paga shpërblime dhe të tjera	324,334,000	307,019,154	17,314,846
601 Kontribute për Sigurime shoqërore	54,156,000	50,144,207	4,011,793
<i>Agjensia e Ofrimit të Shërbimeve të Integruara</i>			
600 Paga shpërblime dhe të tjera	54,795,000	51,953,784	2,841,216
601 Kontribute për Sigurime shoqërore	10,186,000	8,554,211	1,631,789

Burimi i të dhënave: Drejtoria e Operacioneve të Thesarit

Përfundimisht nga ky testim rezulton se, shpenzimet e ligjshme sipas programit (EEP) për llogaritë (600, 601) të realizuara për vitin 2016 nga ADISA, bazuar në listë pagesat, urdhër shpenzimet e thesarit dhe deklarimeve në sistemin e tatimeve, si në nivel vjetor dhe në nivel tremujori, rakordojnë me të dhënat e raportuara nga PMU pranë EBRD-së.

Si konkluzion: Për sa i përket viteve 2016, 2017 dhe 2020, nuk rezulton asnjë një diferencë midis shpenzimeve të ligjshme sipas programit (EEP) për llogaritë (600, 601) të realizuara nga ADISA, bazuar në listë pagesat, urdhër shpenzimet e thesarit dhe deklarimeve në sistemin e tatimeve, si në nivel vjetor dhe në nivel tremujori, dhe të dhënave të raportuara nga PMU pranë EBRD-së.

2.2. MINISTRIA E BRENDSHME (Zyrat e Gjendjes Civile)

Në zbatim të Programit të Auditimit nr. 1179/1, datë 02.11.2021 ôMbi auditimin e projektit ôOfrimi i Shërbimeve Publike me në Qendër Qytetarinôô grupi i auditimit adresoi në ADISA kërkesë për vendosjen në dispozicion të dokumentacionit të të gjitha subjekteve që kanë raportuar për llogaritë 600, 601 me email e datës 08.11.2021.

ADISA me shkresën nr. 899/5, datë 09.11.2021 ôKërkesë për vënien në dispozicion të dokumentacionit justifikues, referuar programit të auditimit ...ô i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile për vendosjen në dispozicion të dokumentat e kërkuara nga grupi i auditimit për përmbushjen e programit të auditimit.

Me shkresat nr. 8243/3-6, datë 24.11.2021, Drejtori i Përgjithshëm i Gjendjes Civile i është drejtuar Kryetarëve të Bashkive për informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar për punonjësit e Gjendjes Civile në bashkitë respektive.

Të dhënat e mëposhtme janë marr dhe përpunuar nga grupi i auditimit nga sistemi i Thesarit.

Auditimi i llogarisë 600 dhe 601, për punonjësit e Zyrave të Gjendjes Civile

Ligji Nr. 139/2015 ôPër vetëqeverisjen vendoreô, kreu VII Funksionet dhe kompetencat e njësive të vetëqeverisjes vendore, Neni 21 ôLlojet e funksioneveô parashikohet:

Pika 1: *Njësitë e vetëqeverisjes vendore ushtrojnë funksione, kompetenca, si dhe funksione të deleguara.*

Pika 3: *Funksionet e deleguara u transferohen njësive të vetëqeverisjes vendore me ligj ose me marrëveshje. Në çdo rast delegimi i funksioneve shoqërohet nga transferta e mjaftueshme e qeverisjes qendrore për të financuar koston e ushtrimit të këtyre funksioneve.*

Këto funksione të deleguara kryhen nga Bashkia dhe konkretisht funksioni i Gjendjes Civile. Sipas Ligjit nr.10 129 datë 11.05.2009, *ôPër Gjendjen Civile* (Ndryshuar me ligjet nr.6/2012, datë 2.2.2012, nr.130/2013, datë 25.4.2013, nr. 134/2016, datë 22.12.2016), Shërbimi Shtetëror i Gjendjes Civile organizohet, si më poshtë vijon:

a) Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile;

b) zyrat e arkivit së gjendjes civile pranë prefektit të qarkut;

c) zyrat e gjendjes civile në bashki/njësi administrative;

ç) shërbimi i gjendjes civile në përfaqësitë diplomatike dhe konsullore shqiptare.

Neni 62 i këtij Ligji citon "Struktura, organika dhe numri i nëpunësve të shërbimit të gjendjes civile në bashki/njësi administrative dhe në zyrat e arkivit të gjendjes civile pranë prefektit të qarkut përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Me Vendimin Nr.1299, datë 16.12.2009 "Për miratimin e strukturës, të organikës dhe të numrit të nëpunësve të shërbimit të gjendjes civile në Bashki/njësi bashkiake/komuna dhe në degët e qarqeve" në pikën 4 është përcaktuar: Numri i zyrave të shërbimit të gjendjes civile është 390 dhe numri i nëpunësve të shërbimit të gjendjes civile është 524 nëpunës.

Në mënyrë të përmbledhur organika e gjendjes civile paraqitet si më poshtë:

Tabela nr.17: Numri i punonjësve të Zyrave të Gjendjes Civile

Nr	Qarku	Z.G.J.C	Nëpunës	Z.G.J.C	Nëpunës	Z.G.J.C	Nëpunës	Z.G.J.C	Nëpunës
	Bashki	Bashki	Bashki	Komuna	Komuna	Rreth	Rreth	Total Qark	Total Qark
1	Berat	7	11	17	17	3	3	27	31
2	Dibër	4	7	28	27	3	3	35	37
3	Durrës	10	24	10	14	2	2	22	40
4	Elbasan	11	18	33	33	4	4	48	55
5	Fier	10	19	34	36	3	3	47	58
6	Gjirokastrë	6	8	16	16	3	3	25	27
7	Korcë	9	15	24	26	4	4	37	45
8	Kukës	3	6	18	18	3	3	24	27
9	Lezhë	5	10	14	14	3	3	22	27
10	Shkodër	5	15	21	24	3	3	29	42
11	Tiranë	16	62	23	26	2	3	41	91
12	Vlorë	11	20	19	21	3	3	33	44
Totali		97	215	257	272	36	37	390	524

Burimi: Vendimi Nr.1299, datë 16.12.2009 /përpunuar nga grupi i auditimit.

Zbatimi i buxhetit për shërbimet e deleguara (Gjendjes civile) bazohet tek Ligji nr. 10129, datë 11.05.2009, "Për gjendjen civile", të ndryshuar; Neni 63 ku përcaktohet se: "Buxheti i shërbimit të gjendjes civile është program më vete, brenda buxhetit të miratuar për Ministrinë e Brendshme" dhe VKM nr. 1299, datë 16.12.2009, të Këshillit të Ministrave, *ôPër miratimin e strukturës, të organikës dhe të numrit të punonjësve të shërbimit të gjendjes civile në bashki/njësi bashkiake/ komuna dhe në degët e qarqeve* i ndryshuar.

Programi buxhetor i gjendjes civile mban kodin 1170. Në këtë program buxhetor Bashkitë alokojnë fondet e pushtetit qendror për funksionin e deleguar të gjendjes civile në njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe mban përshkrimin ôFondet e pushtetit qendror për funksionin e deleguar të gjendjes civile në njësitë e vetëqeverisjes vendore

Nga informacioni i marr nga Ministria e Brendshme, Llogaria 600 dhe 601 për vitin 2016, 2017 dhe 2020 për punonjësit e Zyrës së Gjendjes Civile në programin 1170, paraqitet si në vijim:

Për Vitin 2016

Nga auditimi i bërë në raportimet dhe pagesat e realizuara nëpërmjet Thesarit për shpenzimet dhe të ardhurat për vitin 2016 në Sistemin AMoFIS, për realizimin e Cash/Accrual u procedua si në vijim:

1. Për muajt janar-dhjetor të vitit 2016 u testuan pagesat në databazën e Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit për programin 1170, për zërin 600 (paga) dhe të detajuara llogaritë ekonomike paraqiten si në vijim:

Tabela nr.18: Krahësim i vlerave të raportuara me faktike

në lekë

Gjendja Civile

Programi 1170 Regjistri Gjendjes Civile

Llogaria ekonomike	Përshkrimi llogarisë	DPTH viti 2016	DPTH 2016 Shkresa nr. prot 492 date 30.01.2017	IFRs Report YTD 2016	Diferenca
		Shpenzime nga Thesari		Shpenzime Rritesë YTD 2016	
6001001	Paga baze	142,359,712		<i>Shpenzime të ligjshme (EEP) të raportuara nga PMU pranë EBRD për vitin financiar 2016 (llogaria 600 Paga dhe përfitime të punonjësve)</i>	
6001002	Raport mjeksore të paguara nga punedhenesi	410,451			
6001003	Shtese page për vjetërsi në punë	17,113,879			
6001004	Shtese page për veshitësi dhe rreziqe	2,821,582			
6001005	Shtese page për funksionin	106,791,913			
6001008	Shtese page për kualifikimin	811,545			
6001014	Shtese page për punonjësit që rregullohen me akte të veçanta	42,339			
6001099	Shtesa page të tjera	3,083,429			
6002200	Paga me kontratë për punë sezonale	2,083			
6003900	Të tjera shpërblime për personelin	34,000			
Total 600		273,470,934	307,019,155	307,019,155	-
6010100	Kontribute për sigurime shoqërore	37,300,840		<i>Shpenzime të ligjshme (EEP) të raportuara nga PMU pranë EBRD për vitin financiar 2016 (llogaria 601 Kontribute të punonjësve)</i>	
6011100	Kontribute për sigurime shëndetësore	4,324,993			
Total 601		41,625,833	50,144,000	50,144,000	-
Total		315,096,766	357,163,155	357,163,155	-

Burimi i të dhënave: Grupi i Auditimit nga DPTH

Duhet thënë se gjatë ekstraktimit të databazave të thesarit, muaji prill 2016 nuk kishte asnjë të dhënë apo transaksion të regjistruar në lidhje me shpenzimet e pagave (600) si dhe të kontributeve të sigurimeve (601). Për këtë arsye i kemi referuar komunikimit që ka pasur ADISA me Drejtorinë e Operacioneve të Thesarit, ku kjo e fundit i ka nisur shkresën me nr. prot, 492/1 datë 30.01.2017 ku i kthen përgjigje ADISA-s në lidhje me transaksionet e thesarit për tre institucionet (AKSHI, ADISA dhe Gjendja Civile) referuar shpenzimeve të pagave dhe kontributeve si më poshtë;

Tabela nr.19: Krahësim i vlerave të raportuara me faktike

në lekë

		Plan	Fakt	Fonde
<i>Ministria e Punëve të Brendshme (Gjendja Civile)</i>				
600	Paga shpërblime dhe të tjera	324,334,000	307,019,154	17,314,846
601	Kontribute për Sigurime shoqërore	54,156,000	50,144,207	4,011,793

Burimi i të dhënave: Grupi i Auditimit nga DPTH

Nga ky testim rezulton se, shpenzimet e ligjshme sipas programit (EEP) për llogaritë (600, 601) të realizuara për vitin 2016 nga Zyrtarët e Gjendjes Civile, bazuar në listë pagesat, urdhër shpenzimet e thesarit dhe deklarimeve në sistemin e tatimeve, si në nivel vjetor dhe në nivel tremujor, rakordojnë me të dhënat e raportuara nga PMU pranë EBRD-së. **Pra nuk ka**

diferencë midis të dhënave të nxjerra nga databaza e Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit dhe raportimit të Programit 1170 për zërin 600 dhe 601, për vitin 2016.

2. Për muajt janar-dhjetor të vitit 2016 u testuan pagesat në databazën e Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit për programin 1170, për zërin 600 (paga) dhe 601 (sig. shoqërore dhe shëndetësore punëdhënës) të detajuara sipas Institucioneve, ku nga auditimi situata rezultoi si në vijim:

Tabela nr.20: Shumat për llogaritë 600, 601

në lekë

Nr.	Institucioni	Shuma (llog 600)	Shuma (llog 601)
1	Bashkia Bajram Curri (1836)	4,390,938	654,240
2	Bashkia Ballsh (0924)	3,293,137	487,561
3	Bashkia Belsh (0808)	2,659,024	405,255
4	Bashkia Berat (0202)	5,227,872	829,446
5	Bashkia Bilisht (1505)	3,370,899	513,354
6	Bashkia Bulqize (0603)	3,195,117	528,040
7	Bashkia Cërrik (0808)	2,421,711	386,287
8	Bashkia Çorovode (0232)	2,607,911	465,914
9	Bashkia Delvine (3704)	1,705,217	261,919
10	Bashkia Divjake (0922)	2,704,743	435,358
11	Bashkia Durrës (0707)	11,984,403	1,800,733
12	Bashkia Elbasan (0808)	11,282,663	1,729,641
13	Bashkia Erseke (1514)	1,954,171	320,663
14	Bashkia Fier (0909)	10,306,191	1,589,644
15	Bashkia Finiq (3704)	2,605,054	401,755
16	Bashkia Fushe-Arrëz (3330)	1,483,607	225,657
17	Bashkia Gjirokastrë (1111)	3,088,105	498,161
18	Bashkia Gramsh (0810)	3,537,351	536,492
19	Bashkia Himare (3737)	1,670,697	260,160
20	Bashkia Kamëz (3535)	4,909,444	769,697
21	Bashkia Kavaja (3513)	3,880,163	589,244
22	Bashkia Kelcyre (1128)	1,373,038	234,239
23	Bashkia Konispol (3731)	1,344,100	204,007
24	Bashkia Koplik (3323)	2,976,866	478,646
25	Bashkia Korçë (1515)	6,213,386	1,000,896
26	Bashkia Krujë (0716)	4,812,482	761,593
27	Bashkia Krume (1812)	1,538,229	254,004
28	Bashkia Kuçovë (0217)	2,392,928	394,368
29	Bashkia Kukës (1818)	6,319,200	889,675
30	Bashkia Lac (2019)	3,626,076	590,908
31	Bashkia Lezhë (2020)	5,487,458	882,045
32	Bashkia Libohovë (1111)	661,551	101,300
33	Bashkia Librazhd (0821)	3,160,458	474,048
34	Bashkia Lushnjë (0922)	7,283,697	1,111,840
35	Bashkia Maliq (1515)	3,135,590	550,042
36	Bashkia Mat (0625)	3,868,838	629,403
37	Bashkia Memaliaj (1134)	2,376,163	318,778
38	Bashkia Patos (0909)	2,853,592	438,146
39	Bashkia Peqin (0827)	2,420,861	372,910
40	Bashkia Permet (1128)	2,553,595	385,816
41	Bashkia Peshkopi (0606)	6,721,661	736,479

42	Bashkia Pogradec (1529)	5,230,132	751,248
43	Bashkia Polican (0232)	1,570,757	253,155
44	Bashkia Prenjas (0821)	2,420,072	295,156
45	Bashkia Puke (3330)	1,657,466	231,753
46	Bashkia Pustec (1515)	379,500	57,620
47	Bashkia Rogozhine (3513)	2,290,737	339,238
48	Bashkia Roskovec (0909)	1,886,918	284,374
49	Bashkia Rreshen (2026)	3,238,940	465,331
50	Bashkia Sarande (3731)	2,869,708	432,181
51	Bashkia Selenice (3737)	2,980,428	469,876
52	Bashkia Shijak (0707)	3,004,631	459,392
53	Bashkia Shkoder (3333)	10,223,716	1,668,595
54	Bashkia Tepelene (1134)	1,183,558	179,513
55	Bashkia Tirana (3535)	37,438,084	5,217,416
56	Bashkia Ura Vajguore (0202)	1,704,047	260,875
57	Bashkia Vau Dejes (3333)	2,883,167	482,014
58	Bashkia Vlore (3737)	8,414,884	1,364,007
59	Bashkia Vore (3535)	2,458,538	388,432
60	Komuna Dropull I Poshtem (1111)	1,572,035	252,175
61	Komuna Klos (0625)	1,610,084	267,442
62	N/Prefektura Kavaje (3513)	133,740	22,335
63	N/Prefektura Lushnje (0922)	198,160	33,092
64	N/Prefektura Sarande (3731)	288,480	48,177
65	Prefektura e qarkut Berat (0202)	1,653,839	273,180
66	Prefektura e qarkut Diber (0606)	1,335,939	195,749
67	Prefektura e qarkut Durres (0707)	1,331,519	220,308
68	Prefektura e qarkut Elbasan (0808)	2,021,693	324,861
69	Prefektura e qarkut Fier (0909)	1,586,548	249,885
70	Prefektura e qarkut Gjirokaster (1111)	1,539,500	236,310
71	Prefektura e qarkut Korce (1515)	1,730,733	258,058
72	Prefektura e qarkut Kukes (1818)	1,017,602	152,648
73	Prefektura e qarkut Lezhe (2020)	1,508,043	236,371
74	Prefektura e qarkut Shkoder (3333)	2,011,559	326,244
75	Prefektura e qarkut Tirane (3535)	1,538,149	247,230
76	Prefektura e qarkut Vlore (3737)	1,159,841	183,228
	Total 600 dhe 601	273,470,934	41,625,833

Burimi: Sistemi AMoFTS, Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit/përpunuar nga grupi i auditimit.

Konstatohet se vlera e paguar për secilin Institucion në programin 1170, për zërin 600 dhe 601 përputhet me totalin e pagesave të nxjerra nga Databaza e Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit dhe përpunuara nga grupi i auditimit, për vitin 2016.

Si konkluzion: Për sa i përket vitit 2016, nuk rezulton asnjë një diferencë midis Raportimit të bërë nga Adisa për programin 1170, dhe të dhënave të përpunuara nga auditimi.

Për Vitin 2017

Nga auditimi i bërë në raportimet dhe pagesat e realizuara nëpërmjet Thesarit për shpenzimet dhe të ardhurat për vitin 2017 në Sistemin AMoFTS, për realizimin e Cash/Accrual u procedua si në vijim:

3. Për muajt janar-dhjetor të vitit 2017 u testuan pagesat në databazën e Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit për programin 1170, për zërin 600 (paga) dhe të detajuara llogaritë ekonomike paraqiten si në vijim:

Tabela nr.21: Krahasim i vlerave të raportuara me faktike

në lekë

Gjendja Civile

Programi 1170 Regjistri Gjendjes Civile

Llogaria ekonomike	Përshkrimi llogarisë	DPTH viti 2017	IFRs Report YTD 2017	Diferenca
		Shpenzime nga Thesari	Shpenzime Rritesë YTD 2017	
6001001	Paga baze	159,336,692	<i>Shpenzime të ligjshme (EEP) të raportuara nga PMU pranë EBRD për vitin financiar 2017 (llogaria 600 Paga dhe përfutime të punonjësve)</i>	
6001002	Raporte mjeksore të paguara nga punedhenesi	473,438		
6001003	Shtese page për vjetërsi në punë	20,668,984		
6001004	Shtese page për veshitësi dhe rreziqe	4,760,289		
6001005	Shtese page për funksionin	134,425,010		
6001006	Shtese page për punë në turne të dyta dhe të treta	21,797		
6001008	Shtese page për kualifikimin	894,256		
6001013	Shtese page për punë jashtë orarit	1,125,530		
6001014	Shtese page për punonjësit që rregullohen me akte të veçanta	18,480		
6001020	Shtesë page për diferencë në rastet kur paga e muajit/ve paraardhës është llogaritur më pak	30,640		
6001021	Paga e grupit	805,634		
6001099	Shtesa page të tjera	3,862,281		
6003900	Te tjera shperblime për personelin	593,769		
Total 600		327,016,799	326,382,000	634,799
6010100	Kontribute për sigurime shoqërore	48,649,780	<i>Shpenzime të ligjshme (EEP) të raportuara nga PMU pranë EBRD për vitin financiar 2020 (llogaria 601 Kontribute të punonjësve)</i>	
6011100	Kontribute për sigurime shëndetësore	5,621,621		
Total 601		54,271,401	54,269,000	2,401
		381,288,200	380,651,000	637,200

Burimi i të dhënave: Grupi i Auditimit nga DPTH

Nga ky testim rezultuan diferenca jomateriale të cilat, nga komunikimi me AKSHI, rezultojnë të jenë riklasifikim llogarie si dhe rumbullakim të shifrave, duke qenë se PMU raporton në 000 lekë dhe databaza e thesarit është në lekë.

Pra nuk konstatohen se ka diferenca materiale midis të dhënave të nxjerra nga databaza e Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit dhe raportimit të Programit 1170 për zërin 600, për vitin 2017.

4. Për muajt janar-dhjetor të vitit 2017 u testuan pagesat në databazën e Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit për programin 1170, për zërin 600 (paga) dhe 601 (sig shoqërore dhe shëndetësore punëdhënës) të detajuara sipas Institucioneve, ku nga auditimi situata rezultoi si në vijim:

Tabela nr.22: Gjendje e llogarive

në lekë

Nr.	Institucioni	Shuma (llog 600)	Shuma (llog 601)
1	Bashkia Bajram Curri (1836)	4,568,335	866,159
2	Bashkia Ballsh (0924)	3,899,440	581,209
3	Bashkia Belsh (0808)	3,050,644	513,075
4	Bashkia Berat (0202)	6,339,765	1,061,058
5	Bashkia Bilisht (1505)	3,861,340	644,025
6	Bashkia Bulqize (0603)	4,355,776	730,975

7	Bashkia Cerrik (0808)	3,219,000	512,000
8	Bashkia Corovode (0232)	3,570,260	601,911
9	Bashkia Delvine (3704)	1,941,480	323,948
10	Bashkia Divjake (0922)	3,243,000	545,000
11	Bashkia Dropull (1111)	653,340	109,108
12	Bashkia Durres (0707)	14,605,000	2,315,000
13	Bashkia Elbasan (0808)	13,000,000	2,225,599
14	Bashkia Erseke (1514)	2,525,598	407,262
15	Bashkia Fier (0909)	11,500,000	2,099,996
16	Bashkia Finiq (3704)	3,082,433	485,488
17	Bashkia Fushe-Arrez (3330)	1,751,294	292,881
18	Bashkia Gjirokaster (1111)	3,753,740	626,751
19	Bashkia Gramsh (0810)	4,147,815	695,491
20	Bashkia Himare (3737)	1,745,000	291,419
21	Bashkia Kamez (3535)	5,741,721	959,311
22	Bashkia Kavaja (3513)	4,472,105	738,140
23	Bashkia Kelcyre (1128)	1,573,831	262,592
24	Bashkia Klos (0625)	757,516	126,504
25	Bashkia Konispol (3731)	1,598,705	267,000
26	Bashkia Koplik (3323)	3,800,000	675,000
27	Bashkia Korce (1515)	7,523,468	1,256,421
28	Bashkia Kruje (0716)	5,860,895	982,379
29	Bashkia Krume (1812)	2,000,000	334,000
30	Bashkia Kucove (0217)	3,024,325	505,074
31	Bashkia Kukes (1818)	6,804,649	1,136,379
32	Bashkia Lac (2019)	4,494,573	755,768
33	Bashkia Lezhe (2020)	6,920,520	1,131,838
34	Bashkia Libohove (1111)	816,479	132,050
35	Bashkia Librazhd (0821)	3,565,000	561,268
36	Bashkia Lushnje (0922)	8,593,932	1,435,191
37	Bashkia Maliq (1515)	3,962,989	661,818
38	Bashkia Mat (0625)	4,821,832	805,079
39	Bashkia Memaliaj (1134)	2,686,130	447,658
40	Bashkia Patos (0909)	3,279,534	547,684
41	Bashkia Peqin (0827)	2,746,501	463,710
42	Bashkia Permet (1128)	2,899,876	481,997
43	Bashkia Peshkopi (0606)	8,243,001	1,286,642
44	Bashkia Pogradec (1529)	6,229,909	1,040,099
45	Bashkia Polican (0232)	1,903,406	354,775
46	Bashkia Prenjas (0821)	2,780,488	456,892
47	Bashkia Puke (3330)	1,988,220	326,488
48	Bashkia Pustec (1515)	414,000	69,144
49	Bashkia Rogozhine (3513)	2,642,872	460,545
50	Bashkia Roskovec (0909)	2,533,744	424,145
51	Bashkia Rreshen (2026)	3,890,000	618,434
52	Bashkia Sarande (3731)	3,021,441	504,583
53	Bashkia Selenice (3737)	3,457,017	583,382
54	Bashkia Shijak (0707)	3,575,769	583,383
55	Bashkia Shkoder (3333)	12,698,450	2,120,639
56	Bashkia Tepelene (1134)	1,394,820	232,956
57	Bashkia Tirana (3535)	43,301,519	7,122,508

58	Bashkia Ura Vajgurore (0202)	2,044,195	341,534
59	Bashkia Vau Dejes (3333)	3,679,187	573,982
60	Bashkia Vlore (3737)	10,324,229	1,593,447
61	Bashkia Vore (3535)	2,833,000	473,000
62	Komuna Dropull I Poshtem (1111)	1,282,562	214,187
63	Komuna Klos (0625)	1,448,484	241,892
64	Prefektura e qarkut Berat (0202)	1,962,640	327,759
65	Prefektura e qarkut Diber (0606)	1,779,071	297,097
66	Prefektura e qarkut Durres (0707)	1,661,919	277,540
67	Prefektura e qarkut Elbasan (0808)	2,447,841	408,787
68	Prefektura e qarkut Fier (0909)	1,881,656	322,359
69	Prefektura e qarkut Gjirokaster (1111)	1,659,731	277,739
70	Prefektura e qarkut Korce (1515)	2,245,244	374,953
71	Prefektura e qarkut Kukes (1818)	1,800,000	319,369
72	Prefektura e qarkut Lezhe (2020)	2,312,000	386,108
73	Prefektura e qarkut Shkoder (3333)	2,437,441	407,053
74	Prefektura e qarkut Tirane (3535)	2,404,739	347,106
75	Prefektura e qarkut Vlore (3737)	1,980,363	307,658
	Total 600 dhe 601	327,016,799	54,271,401

Burimi: Sistemi AMoFTS, Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit/përpunuar nga grupi i auditimit.

Konstatohet se vlera e paguar për secilin Institucion në programin 1170, për zërin 600 dhe 601 përputhet me totalin e pagesave të nxjerra nga Databaza e Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit dhe përpunuara nga grupi i auditimit, për vitin 2017.

Si konkluzion: Për sa i përket vitit 2017, nuk rezulton asnjë një diferencë midis Raportimit të bërë nga ADISA për programin 1170, dhe të dhënave të përpunuara nga auditimi.

Për Vitin 2020

Nga auditimi i bërë në raportimet dhe pagesat e realizuara nëpërmjet Thesarit për shpenzimet dhe të ardhurat për vitin 2020 në Sistemin AMoFTS, për realizimin e Cash/Accrual u procedua si në vijim:

Për muajt janar-dhjetor të vitit 2020 u testuan pagesat në databazën e Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit për programin 1170, për zërin 600 (paga) dhe të detajuara llogaritë ekonomike paraqiten si në vijim:

Tabela nr.23: Krahësim i vlerave të raportuara me faktike

në lekë

Gjendja Civile

Programi 1170 Regjistri Gjendjes Civile

Llogaria ekonomike	Përshkrimi llogarisë	DPTH viti 2020	IFRs Report YTD 2020	Diferenca
		Shpenzime nga Thesari	Shpenzime Rritese YTD 2020	
6001001	Paga baze	162,502,488	<i>Shpenzime të ligjshme (EEP) të raportuara nga PMU pranë EBRD për vitin financiar 2020 (llogaria 600 Paga dhe përfitime të punonjësve)</i>	
6001002	Raporte mjeksore të paguara nga punedhenesi	635,852		
6001003	Shtese page për vjetërsi në punë	21,781,635		
6001004	Shtese page për vështirësi dhe rreziqe	1,155,472		
6001005	Shtese page për funksionin	144,915,205		
6001006	Shtese page për punë në turne të dyta dhe të treta	68,590		
6001008	Shtese page për kualifikimin	1,044,000		
6001010	Pagese për ushtarakët e liruuar në reforme	75,785		
6001013	Shtese page për punë jashtë orarit	160,395		
6001014	Shtese page për punonjësit që rregullohen me akte të veçanta	7,031		
				11,714

6001021	Paga e grupit	878,636		
6001099	Shtesa page te tjera	2,068,122		
6003900	Te tjera shperblime per personelin	137,628		
6009100	Shpenzime te tjera personeli	46,875		
Total 600		335,477,714	335,466,000	
6010100	Kontribute per sigurime shoqerore	50,062,875	<i>Shpenzime të ligjshme (EEP) të raportuara nga PMU pranë EBRD për vitin financiar 2020 (llogaria 601 Kontribute të punonjësve)</i>	
6011100	Kontribute per sigurime shendetesore	5,497,079		
Total 601		55,559,954		
		391,037,668	391,026,000	(46)
				11,668

Burimi i të dhënave: Grupi i Auditimit nga DPTH

Nga ky testim rezultuan diferenca jomateriale të cilat, nga komunikimi me AKSHI, rezultojnë të jenë riklasifikim llogarie si dhe rumbullakim të shifrave, duke qenë se PMU raporton në 000 lekë dhe databaza e thesarit është në lekë.

Si konkluzion: Nuk ka diferencë materiale midis të dhënave të nxjerra nga databaza e Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit dhe raportimit të Programit 1170 për zërin 600 dhe 601, për vitin 2020.

5. Për muajt janar-dhjetor të vitit 2020 u testuan pagesat në databazën e Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit për programin 1170, për zërin 600 (paga) dhe 601 (sig shoqërore dhe shëndetësore punëdhënës) të detajuara sipas Institucioneve, ku nga auditimi situata rezultoi si në vijim:

Tabela nr.24: Gjendja e llogarive 600, 601

në lekë

Nr.	Institucioni	Shuma (llog 600)	Shuma (llog 601)
1	Bashkia Bajram Curri (1836)	5,060,901	783,560
2	Bashkia Belsh (0808)	3,239,537	548,133
3	Bashkia Berat (0202)	6,610,921	971,053
4	Bashkia Bilisht (1505)	3,943,516	658,580
5	Bashkia Bulqize (0603)	4,550,000	751,000
6	Bashkia Cërrik (0808)	3,000,000	515,000
7	Bashkia Corovode (0232)	3,764,412	598,072
8	Bashkia Delvine (3704)	1,803,112	301,115
9	Bashkia Divjake (0922)	3,137,840	522,732
10	Bashkia Dropull (1111)	1,683,023	281,069
11	Bashkia Durrës (0707)	14,861,048	2,467,147
12	Bashkia Elbasan (0808)	13,500,000	2,260,523
13	Bashkia Erseke (1514)	2,400,652	400,896
14	Bashkia Fier (0909)	12,799,562	2,199,835
15	Bashkia Finiq (3704)	3,086,870	514,292
16	Bashkia Fushe-Arrez (3330)	1,566,774	255,860
17	Bashkia Gjirokaster (1111)	3,791,731	633,208
18	Bashkia Gramsh (0810)	4,187,766	699,258
19	Bashkia Himare (3737)	1,808,637	302,043
20	Bashkia Kamez (3535)	5,749,691	868,324
21	Bashkia Kavaja (3513)	4,777,920	788,000
22	Bashkia Kelcyre (1128)	1,378,800	225,252
23	Bashkia Klos (0625)	2,400,000	380,998
24	Bashkia Konispol (3731)	1,700,000	254,000
25	Bashkia Koplik (3323)	3,801,909	634,922

26	Bashkia Korce (1515)	7,737,923	1,292,242
27	Bashkia Kruje (0716)	5,952,300	969,957
28	Bashkia Krume (1812)	2,211,549	340,000
29	Bashkia Kucove (0217)	2,986,526	495,071
30	Bashkia Kukes (1818)	7,093,379	1,099,997
31	Bashkia Lac (2019)	4,442,761	734,112
32	Bashkia Lezhe (2020)	6,965,260	1,163,199
33	Bashkia Libohove (1111)	840,000	140,280
34	Bashkia Librazhd (0821)	3,810,948	591,630
35	Bashkia Lushnje (0922)	8,935,179	1,480,000
36	Bashkia Maliq (1515)	3,683,006	615,061
37	Bashkia Mallakaster (0924)	4,100,000	677,950
38	Bashkia Mat (0625)	4,863,408	812,285
39	Bashkia Memaliaj (1134)	2,819,881	449,997
40	Bashkia Patos (0909)	3,391,205	566,343
41	Bashkia Peqin (0827)	3,167,520	525,000
42	Bashkia Permet (1128)	2,823,921	471,595
43	Bashkia Peshkopi (0606)	8,499,128	1,437,016
44	Bashkia Pogradec (1529)	6,400,000	1,080,000
45	Bashkia Polican (0232)	1,996,535	330,000
46	Bashkia Prenjas (0821)	2,614,775	436,221
47	Bashkia Puke (3330)	1,812,011	302,608
48	Bashkia Pustec (1515)	473,439	77,975
49	Bashkia Rogozhine (3513)	2,999,475	433,649
50	Bashkia Roskovec (0909)	2,547,296	425,370
51	Bashkia Rreshen (2026)	3,899,963	835,710
52	Bashkia Sarande (3731)	2,879,134	475,423
53	Bashkia Selenice (3737)	3,519,711	541,414
54	Bashkia Shijak (0707)	3,800,000	711,552
55	Bashkia Shkoder (3333)	12,750,000	2,129,245
56	Bashkia Tepelene (1134)	1,640,000	220,000
57	Bashkia Tirana (3535)	44,090,613	7,300,000
58	Bashkia Ura Vajgurore (0202)	2,498,072	389,744
59	Bashkia Vau Dejes (3333)	3,408,050	562,967
60	Bashkia Vlore (3737)	10,420,000	1,830,598
61	Bashkia Vore (3535)	2,898,937	480,314
62	Prefektura e qarkut Berat (0202)	1,930,378	326,591
63	Prefektura e qarkut Diber (0606)	2,010,711	335,000
64	Prefektura e qarkut Durres (0707)	1,589,980	265,526
65	Prefektura e qarkut Elbasan (0808)	2,351,125	392,689
66	Prefektura e qarkut Fier (0909)	2,181,810	364,365
67	Prefektura e qarkut Gjirokaster (1111)	1,663,037	277,725
68	Prefektura e qarkut Korce (1515)	2,245,015	374,410
69	Prefektura e qarkut Kukes (1818)	2,334,172	389,808
70	Prefektura e qarkut Lezhe (2020)	2,409,839	398,634
71	Prefektura e qarkut Shkoder (3333)	2,484,720	414,949
72	Prefektura e qarkut Tirane (3535)	2,220,720	370,860
73	Prefektura e qarkut Vlore (3737)	2,479,680	410,000
	Totali	335,477,714	55,559,954

Burimi: Sistemi AMoFIS, Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit/përpunuar nga grupi i auditimit.

Konstatohet se vlera e paguar për secilin Institucion në programin 1170, për zërin 600 dhe 601 përputhet me totalin e pagesave të nxjerra nga Databaza e Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit dhe përpunuara nga grupi i auditimit, për vitin 2020.

Si konkluzion: Për sa i përket vitit 2020, nuk rezulton asnjë një diferencë midis Raportimit të bërë nga ADISA për programin 1170, dhe të dhënave të përpunuara nga auditimi.

2.3. AGJENCIA KOMBËTARE E SHOQËRISË SË INFORMACIONIT (AKSHI)

Në institucionin AKSHI marrëdhëniet e punës janë rregulluar me Ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar. Nga auditimi nuk rezultuan tejkalime të strukturës së miratuar. Në tabelën e mëposhtme pasqyrohet krahasimi i strukturës së planifikuar me strukturën e realizuar për vitin 2016, 2017 dhe 2020:

Tabela nr.25: Struktura e AKSHI

Vitet	Struktura e miratuar (Nr)	
	Plan	Fakt
Viti 2016	101	67
viti 2017	153	105
viti 2020	315	245

Burimi: AKSHI/Drejtoria e Burimeve Njerëzore.

Nga auditimi i ushtruar në institucionin Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) lidhur me shpenzimet e llogarive 600 dhe 601 për vitin 2016, 2017 dhe 2020 u konstatua se:

-Për vitin 2016 vlera e raportuar për zërat 600 dhe 601 në Drejtorinë e Thesarit referuar evidencave mujore përputhet me urdhër shpenzimet e pagave dhe kontributeve.

-Për vitin 2017 konstatohet se për llogarinë 600 óShpenzime pageô dhe për llogarinë 601 óKontribute sigurime shoqërore&shëndetësoreô referuar evidencave vjetore totale përputhen me urdhër shpenzimet e pagave dhe kontributeve.

-Për vitin 2020 vlera e raportuar për zërat 600 dhe 601 në Drejtorinë e Thesarit referuar evidencave mujore përputhet me urdhër shpenzimet e pagave dhe kontributeve.

Tabela nr.26: Buxhet – Fakt llogaritë 600, 601 në lekë

AKSHI	Llogaritë	Buxheti i parashikuar	Shpenzimet e realizuara vjetore	Diferenca	Diferenca %
2016	Llog. 600	87,055,000	75,068,637	11,986,363	86.2%
	Llog. 601	14,200,000	11,900,007	2,299,993	83.8 %
2017	Llog. 600	114,760,000	84,486,251	30,273,749	73.6%
	Llog. 601	19,035,000	13,469,386	5,565,614	70.8%
2020	Llog. 600	308,816,000	279,043,536	29,772,464	90.4%
	Llog. 601	52,415,000	45,963,547	6,541,453	87.7%

Burimi i të dhënave: Grupi i Auditimit

Për sa i përket shpenzimeve janë bërë testimet përkatëse për vitet 2016, 2017 dhe 2020 për llogaritë e shpenzimeve të pagave dhe të kontributeve të sigurimeve (600 dhe 601).

Për vitin 2016

Nga databaza e Thesarit të DPTH pjesë e MFE-së, janë nxjerrë shpenzimet e pagave dhe të kontributeve (600 dhe 601), të cilat mbulohen nga marrëveshja e huasë (IBRD Loan 8521 në AL) nëpërmjet Programit 1140 ó Shërbimet e Shoqërisë së Informacionit në sistemin SIFQ për vitin 2016 dhe janë krahasuar me raportimet IFRs së PMU në EBRD;

AKSHI

Tabela 27: Programi 1140 Shërbimet e Shoqërisë së Informacionit

Llogaria ekonomike	Përshkrimi llogarisë	DPTH viti 2016	DPTH 2016 Shkresa nr.prot 492 date 30.01.2017	IFRs Report YTD 2016	Diferenca
		Shpenzime nga Thesari		Shpenzime Rritese YTD 2016	
6001001	Paga baze	52,221,672		<i>Shpenzime të ligjshme (EEP) të raportuara nga PMU pranë EBRD për vitin financiar 2016 (llogaria 600 Paga dhe përfitime të punonjësve)</i>	
6001003	Shtese page per vjetërsi ne pune	1,260,140			
6001005	Shtese page per funksionin	13,960,000			
Total 600		67,441,812	75,068,637	75,068,637	-
6010100	Kontribute per sigurime shoqerore	9,172,497		<i>Shpenzime të ligjshme (EEP) të raportuara nga PMU pranë EBRD për vitin financiar 2016 (llogaria 601 Kontribute të punonjësve)</i>	
6011100	Kontribute per sigurime shendetesore	740,717			
Total 601		9,913,214	11,900,007	11,900,007	-

Burimi i të dhënave: Grupi i Auditimit nga DPTH

Duhet thënë se gjatë ekstraktimit të databazave të thesarit, muaji prill 2016 nuk kishte asnjë të dhënë apo transaksion të regjistruar në lidhje me shpenzimet e pagave (600) si dhe të kontributeve të sigurimeve (601). Për këtë arsye i jemi referuar komunikimit që ka pasur ADISA me Drejtorinë e Operacioneve të Thesarit, ku kjo e fundit i ka nisur shkresën me nr.prot, 492/1 datë 30.01.2017 ku i kthen përgjigje ADISA-s në lidhje me transaksionet e thesarit për tre institucionet (AKSHI, ADISA dhe Gjendja Civile) referuar shpenzimeve të pagave dhe kontributeve si më poshtë;

Tabela nr.28: Krahasim i vlerave të raportuara me faktike

në lekë

		Plan	Fakt	Fonde
Agjensia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit				
600	Paga shpërblime dhe të tjera	87,055,000	75,068,637	11,986,363
601	Kontribute për Sigurime shoqërore	14,200,000	11,900,007	2,299,993

Burimi: Sistemi i Thesarit

Për vitin 2017

Nga databaza e Thesarit të DPTH pjesë e MFE-së, janë nxjerrë shpenzimet e pagave dhe të kontributeve (600 dhe 601), të cilat mbulohen nga marrëveshja e huasë (IBRD Loan 8521 në AL) nëpërmjet Programit 1140 ó Shërbimet e Shoqërisë së Informacionit në sistemin SIFQ për vitin 2017 dhe janë krahasuar me raportimet IFRs së PMU në EBRD;

AKSHI

Tabela 29: Programi 1140 Shërbimet e Shoqërisë së Informacionit

në lekë

Llogaria ekonomike	Përshkrimi llogarisë	DPTH viti 2017	IFRs Report YTD 2017	Diferenca
		Shpenzime nga Thesari	Shpenzime Rritese YTD 2017	
6001001	Paga baze	67,490,100	<i>Shpenzime të ligjshme (EEP) të raportuara nga PMU pranë EBRD për vitin financiar 2017 (llogaria 600 Paga dhe përfitime të punonjësve)</i>	
6001003	Shtese page per vjetërsi ne pune	1,307,974		
6001005	Shtese page per funksionin	15,688,227		
Total 600		84,486,301	84,468,000	18,301
6010100	Kontribute per sigurime shoqerore	12,033,659	<i>Shpenzime të ligjshme (EEP) të raportuara nga PMU pranë EBRD për vitin financiar 2017 (llogaria 601 Kontribute të punonjësve)</i>	
6011100	Kontribute per sigurime shendetesore	1,435,727		

<i>Total 601</i>	<i>13,469,386</i>	<i>13,469,000</i>	
	<i>97,955,687</i>	<i>97,937,000</i>	<i>18,687</i>

Burimi i të dhënave: Grupi i Auditimit nga DPTH

Nga ky testim rezultuan diferenca jomateriale të cilat, nga komunikimi me AKSHI, rezultojnë të jenë riklasifikim llogarie si dhe rumbullakim të shifrave, duke qenë se PMU raporton në 000 lekë dhe databaza e thesarit është në lekë.

Për vitin 2020

Nga databaza e Thesarit të DPTH pjesë e MFE-së, janë nxjerrë shpenzimet e pagave dhe të kontributeve (600 dhe 601), të cilat mbulohen nga marrëveshja e huasë (IBRD Loan 8521 në AL) nëpërmjet Programit 1140 ó Shërbimet e Shoqërisë së Informacionit në sistemin SIFQ. Këto shpenzime për AKSHI-n, janë nxjerrë dhe krahasuar me IFRs në nivel vjetor si më poshtë;

AKSHI

Tabela 30: Programi 1140 Shërbimet e Shoqërisë së Informacionit

në lekë

Llogaria ekonomike	Përshkrimi llogarisë	DPTH viti 2020	IFRs Report YTD 2020	Diferenca
		Shpenzime nga Thesari	Shpenzime Rritesë YTD 2020	
6001001	Paga baze	42,344,838	<i>Shpenzime të ligjshme (EEP) të raportuara nga PMU pranë EBRD për vitin financiar 2020 (llogaria 600 Paga dhe përfitime të punonjësve)</i>	(1)
6001002	Raporte mjeksore të paguara nga punedhenesi	534,930		
6001003	Shtese page për vjetërsi në punë	1,343,625		
6001005	Shtese page për funksionin	60,000		
6001016	Shtesë page për natyrë të veçantë pune/kushte pune	13,885,956		
6001020	Shtesë page për diferencë në rastet kur paga e muajit/ve paraardhës është llogaritur më pak	379,953		
6001021	Paga e grupit	8,446,984		
6002100	Paga me kontratë për kohë të kufizuar	-		
6003100	Shperblime për rezultate në punë	106,703		
<i>Total 600</i>		<i>67,102,989</i>	<i>67,102,990</i>	
6010100	Kontribute për sigurime shoqërore	9,884,195	<i>Shpenzime të ligjshme (EEP) të raportuara nga PMU pranë EBRD për vitin financiar 2020 (llogaria 600 Paga dhe përfitime të punonjësve)</i>	3
6011100	Kontribute për sigurime shëndetësore	1,140,668		
<i>Total 601</i>		<i>11,024,863</i>	<i>11,024,860</i>	
<i>Total</i>		<i>78,127,852</i>	<i>78,127,850</i>	2

Burimi i të dhënave: Grupi i Auditimit nga DPTH

Konkluzion: Për sa i përket viteve 2016, 2017 dhe 2020, nuk rezulton asnjë një diferencë materiale midis shpenzimeve të ligjshme sipas programit (EEP) për llogaritë (600, 601) të realizuara nga AKSHI, bazuar në listë pagesat, urdhër shpenzimet e thesarit dhe deklarimeve në sistemin e tatimeve, dhe të dhënave të raportuara nga PMU pranë EBRD-së.

2.4. AGJENCIA SHETETËRORE E KADASTRËS/ISH-ZYRA E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME (ASHK).

Ish-Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (sot Agjencia Shtetërore e Kadastrës) ka funksionuar si institucion publik juridik, jo buxhetor në varësi të Ministrit të Drejtësisë, bazuar në Ligjin nr. 33/2012, datë 21.03.2012, óPër regjistrimin e pasurive të paluajtshme. Organet drejtuese të ish-ZRPP kanë qenë Bordi Drejtues dhe Kryeregjistruesi. Aktivitetin e saj e ka ushtruar nëpërmjet Zyrës Qendrore në qytetin e Tiranës dhe 35 zyrave vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme nëpër rrethe. Organizimi dhe funksionimi i ish-ZRPP bazohej në rregulloren e brendshme miratuar me vendimin nr. 7, datë 24.11.2016, të Bordit Drejtues sipas

shkresës nr. 920 prot., datë 24.11.2016, rregullore e cila aplikohej edhe në ish-zyrat vendore në rrethe.

Për vitin 2016 dhe 2017: Burimet e financimit janë të ardhurat e veta, të krijuara nga vjelja e tarifave nga shërbimet e ofruara prej zyrave vendore, tarifa të cilat janë të përcaktuara në VKM-në nr. 576, datë 29.08.2012, óPër përcaktimin e listës së shërbimeve që ofron ZRPPó dhe Udhëzimit të përbashkët të MD dhe MFE nr. 5341/5, datë 07.09.2012, óPër miratimin e tarifave të shërbimit të ZRPPó.

Për vitin 2020:Në zbatim të Ligjit nr. 111/2018, datë 07.03.2018, óPër kadastrënó, ish-ZRPP dhe ish-ALUIZNI janë bashkuar në një institucion të vetëm duke krijuar Agjencinë Shtetërore të Kadastrës. Organet drejtuese të ASHK-së janë Këshilli Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm.

ASHK është e organizuar në nivel qendror nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme në qytetin e Tiranës dhe në nivel vendor, në drejtori si struktura varësie në qytetet Tiranë, Durrës, Elbasan, Vlorë, Kamëz-Vlorë, Shkodër, Fier, Korçë, Lezhë, Berat, Kavajë, Gjirokastrë, Krujë, Lushnjë, Pogradec, Sarandë, Dibër, Kukës, Zonat e Stimuluara, Kuçovë dhe Tepelenë.

Nga auditimi i ushtruar në ASHK (si Agjenci Pjesëmarrëse e Projektit) për Projektin óOfrimi i shërbimeve publike me në qendër qytetarinó lidhur me shpenzimet e ligjshme të Programi EEP për llogaritë (600, 601) të cilat mbulohen me financim nga Projekti, grupi i auditimit me përzgjedhje ka audituar DPASHK/ish-ZQRPP duke u bazuar në numrin e strukturës organizative si dhe shpenzimeve më të larta për këto llogari. Në gjykimin e grupit të auditimit kjo përzgjedhje është kryer duke marrë në konsideratë se, gabimet materiale mund të jenë më të larta aty ku transaksionet janë më të larta në llogaritë (600, 601).

Marrëdhëniet e punës me punonjësit e saj i ka rregulluar me anë të kontratave individuale të punës bazuar në Ligjin nr. 9152, datë 29.07.2003, óKodi i punës i Republikës së Shqipërisëó i ndryshuar. Strukturat organizative për vitet 2018 dhe 2019, për ASHK/ish-ZRPP për të gjithë sistemin janë miratuar sipas urdhrave të Kryeministrit si më poshtë:

- **Për vitin 2016** ish-ZRPP për miratimin e strukturës organizative është bazuar në Urdhrin e Kryeministrit nr. 33, datë 02.04.2013, në zbatim të Ligjit nr. 33/2012, óPër regjistrimin e pasurive të paluajtshmeó, ku është miratuar struktura organizative me numër 688 punonjës për të gjithë sistemin, ku pjesë përbërëse e kësaj strukture 107 punonjës i përkasin ish-ZQRPP. Urdhërin e Kryeministrit nr. 196, datë 04.08.2014 ópër ndryshime dhe shtesa në Unrdhrin nr. 33...ó

- **Për vitin 2020**, me Urdhër të Kryeministrit nr. 84, datë 02.05.2019, sipas pikës 2, neni 7, të Ligjit nr. 111/2018, datë 07.03.2018, óPër kadastrënó, është miratuar struktura organizative për Agjencinë Shtetërore të Kadastrës me numër 993 punonjës për gjithë sistemin (688 punonjës ish-ZRPP + 305 punonjës ish-ALUIZNI), ku pjesë përbërëse e kësaj strukture organizative 158 punonjës i përkasin DPASHK. Strukturës organizative të DPASHK janë bashkuar 10 punonjës me kontratë sipas Vendimit nr. 9, datë 20.12.2018, të Këshillit Drejtues.

Kriteret për pozicionet e punës për ASHK/ish-ZRPP për të gjithë sistemin janë miratuar sipas VKM-ve konkretisht, për vitin 2016 dhe 2017 është bazuar në VKM nr. 217, datë 20.03.2013, óPër miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të ZRPPó ndërsa për vitin 2020 është bazuar në VKM nr. 245, datë 24.04.2019, óPër miratimin e strukturës dhe nivelit të pagave e të shtesave mbi pagë të nëpunësve dhe punonjësve administrativë në ASHKó.

ASHK/ish-ZRPP në lidhje me caktimin e nivelit të pagave është bazuar në referencat e përcaktuara në VKM-në nr. 187, datë 08.03.2017, óPër miratimin e strukturës dhe nivelit të pagave.....ó. Pagat janë të grupuara në katër nivele për secilin pozicion pune konkretisht niveli I,

II, III dhe IV dhe secili nivel ka një limit të përcaktuar. Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, lidhur me procedurat të cilat janë ndjekur nga DPASHK/ish-ZQRPP për mbajtjen e pagave konstatohet se:

Listë pagesat përfshijnë, pagën e grupit (klasifikimi i diplomës së nivelit të dytë në master shkencor ose profesional), pagën për funksion (niveli e klasifikuar), pagën për kushte pune (i përket seleksionimit të pozicionit të vështirësive të kushteve tekniko profesionale të punës), raportet mjekësore të paguara nga punëmarrësi, shtesa vjetërsi (klasifikimi në vit, % dhe në vlerë), paga bruto, ndalesa (pagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore 9.5%, pagesat e kontributeve të sigurimeve shëndetësore 1.7%, tatimi mbi pagën). Listë prezencat janë hartuar sipas ditëve gjithsej të punës për çdo punonjës. Paga e aplikuar minimale është 29,500 lekë paga maksimale 118,100 lekë. Për sa i përket shpërblimeve për orët jashtë orarit të punës nuk ka, për shkak se nuk janë shfrytëzuar orët jashtë orarit zyrtar, pasi punonjësit i përmbahen 40 orëve në javë, sipas orarit të shpallur në rregulloren e brendshme të institucionit si dhe në përputhje me kontrata individuale të punës.

Për periudhën e audituar, me zgjedhje u audituan 50 dosje të personelit të DPASHK/ish-ZQRPP, përzgjedhja u krye duke u bazuar në nivelet më të larta të pagave (nivelet e pagave II-a 118,100 lekë, II-b 100,000 lekë, III-a 80,800 lekë, III a/1 70,500 lekë, III-b 61,000 lekë dhe IV-a 49,000 lekë) ku është konstatohet se, pozicionet e punës përputhen me kriteret e miratuara sipas VKM nr. 217, datë 20.03.2013, óPër miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të ZRPPó, dhe VKM nr. 245, datë 24.04.2019, óPër miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave e të shtesave mbi pagë të nëpunësve dhe punonjësve administrativë në ASHKó, urdhrat e emërimeve dhe nivelin e pagave si dhe klasifikimi në kategoritë e diplomave të nivelit të parë dhe të dytë (bachelor, master profesional dhe shkencor) janë aplikuar sipas kuadrit rregullator ligjor përkatës.

Dokumentacioni i dosjeve në përgjithësi është i plotë ku pjesë përbërëse janë kartat e identitetit, certifikatat familjare, dëftesa/diplomat e nivelit të parë dhe nivelit të dytë të studimeve të larta (fotokopjo të noterizuara), listë notash, vërtetime shëndetësore, certifikata në lidhje me trajnimet dhe gjuhët e huaja, dëshmi penaliteti etj...

Nga auditimi me zgjedhje i borderove dhe listë pagesave për muajt janar, tetor, dhjetor (2016) për Durrës, Tiranë, Vlorë, shkurt, gusht, nëntor (2017) për Fier, Shkodër, Durrës dhe maj, shtator, dhjetor (2020) për Tirana 1, Vlorë, Korçë.

Listë prezencat e mbajtura lidhur me realizimin e ditëve të punës të paguara për punonjësit rakordojnë me listë pagesat si dhe me dokumentacionin e pagesave bankare.

Aplikimi i pagës për funksion pune dhe pagës së grupit (klasifikimi i diplomës së nivelit të parë dhe të dytë: 14,000 lekë, 11,000 lekë dhe 10,000 lekë) është kryer konformë përcaktimeve të VKM-së 187, datë 08.03.2017, bazuar edhe në urdhrat e emërimit të punonjësve apo kontratave individuale të punës.

Për sa i përket auditimit me zgjedhje të 50 dosjeve të personelit, klasifikimi i kategorive së diplomës së nivelit të parë dhe të dytë rakordon me të dhënat e paraqitura në bordero. Përlllogaritja e shtesës së vjetërsisë në punë është kryer konform përcaktimeve të VKM-së nr. 187, datë 08.03.2017, konkretisht sipas formulës {2% * pagën e grupit (klasifikimi sipas diplomës së nivelit të dytë master shkencor dhe profesional) * vitet e punës} bazuar edhe në vjetërsinë e punës të paraqitur në librezat e punës.

DPASHK/ish-ZQRPP për kryerjen e pagesave për pagat dhe kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, ushtron veprimtarinë e saj nëpërmjet bankave, Intesa San Paolo Bankë, ABI Bankë, Credins Bankë, Banka Tregtare Kombëtare dhe Raiffeisen Bankë.

Paga shpërblime e të tjera personeli dhe pagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si dhe regjistrimi i tyre në kontabilitet.

Kontabiliteti është i organizuar dhe i mbajtur në zbatim të kërkesave të Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004, óPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareó i ndryshuar, Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, óPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëó i ndryshuar, dhe Standardeve Kombëtarë të Kontabilitetit të shpallura nga Ministria e Financave.

ASHK/ish-ZRPP ka mbajtur në llogaritë e saj aktivet, pasivet dhe transaksionet financiare të rezultuara nga veprimtaria e saj për të gjithë sistemin. Duke qenë se drejtoritë vendore dhe ish-zyrat vendore janë si një varësi të DPASHK/ish-ZQRPP, dorëzojnë pasqyrat vjetore të cilat unifikohen në një pasqyrë financiare të vetme nga DPASHK/ish-ZQRPP, të cilat dërgohen për miratim pranë Degës së Thesarit Tiranë.

Për sa i përket auditimit të llogarive (600, 601) konstatohet se, llogaritja e pagave dhe shpërblimeve nuk mbahet në programi financiar, por në Excel dhe hidhet me veprim ekstra kontabël. Regjistrimet kontabël janë të pajisur me evidencë mbështetëse që sigurojnë besueshmërinë e tyre. Regjistrat janë të mbajtur në gjuhën shqipe dhe vlerat në njësitë monetare shqiptare LEKË.

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

PASIVI (DETYRIMET AFATSHKURTRA)

□ Llogaritë e detyrimeve të personelit dhe të tjera detyrime të lidhura me to

Në këtë llogari janë evidentuar detyrimet për paga të personelit dhe detyrimet e tjera të lidhura me to të pagueshme në fund të periudhës ushtrimore si pasojës e pagesave të llogaritura në muajin Dhjetor. Në këtë zë të pasqyrave financiare janë paraqitur shpenzimet për detyrime të konstatuara dhe të tjera lidhura me to në kuadër të rakordimit me llogarinë e financimit të pritshëm nga buxheti. Për efekt të hartimit të pasqyrave financiare, këto llogari pasqyrohen në shpenzimet e periudhës ushtrimore, në pasqyrën e shpenzimeve, si paga të konstatuara për aq kohë sa këto detyrime maturohen në mbylljen e vitit. Rrjedhimisht, duke qenë se është njohur si shpenzim i cili nuk është paguar ende, është njohur si detyrim përkatës në pasqyrën financiare.

□ Detyrimet e personelit të paraqitura në pasqyrën financiare, i përkasin detyrimeve për pagat e muajit dhjetor të vitit 2016, të detajuara si më poshtë:

Tabela nr.31: Gjendje e llogarive në lekë

Numri i llogarisë	Emërtimi i llogarisë te pasivit	2016/leke
42	Personeli e llogari te lidhura me to	12.060.425
431	Detyrime ndaj Shtetit per tatim-taksa	4.797.874
435	Sigurime shoqerore	14.610.366
436	Sigurime shendetstore	2.005.080
437,438	Organizma te tjere shoqerore	0

Burimi i të dhënave: Grupi i Auditimit nga DPTH

Këto detyrime, janë likuiduar në vitin pasardhës në muajin janar të vitit 2017. Për vitin 2016 nuk ka detyrime të prapambetura ose të paguara.

■ Detyrimet e personelit të paraqitura në pasqyrën financiare, i përkasin detyrimeve për pagat e muajit dhjetor të vitit 2017, të detajuara si më poshtë:

Tabela nr.32: Gjendje e llogarive në lekë

Numri i llogarise	Emertimi i llogarise te pasivit	2017/leke
42	Personeli e llogari te lidhura me to	6.790.427
431	Detyrime ndaj Shtetit per tatim-taksa	4.594.888
435	Sigurime shoqerore	15.464.424
436	Sigurime shendetesore	2.059.784
437,438	Organizma te tjere shoqerore	0

Burimi i të dhënave: Grupi i Auditimit nga DPTH

Këto detyrime, janë likuiduar në vitin pasardhës, në muajin janar të vitit 2018. Për vitin 2017 nuk ka detyrime të prapambetura ose të papaguara.

- Detyrimet e personelit të paraqitura në pasqyrën financiare, i përkasin detyrimeve për pagat e muajit dhjetor të vitit 2020, të detajuara si më poshtë:

Tabela nr.33: Gjendje e llogarive në lekë

Numri i llogarise	Emertimi i llogarise te pasivit	2020/leke
42	Personeli e llogari te lidhura me to	1.740.340
431	Detyrime ndaj Shtetit per tatim-taksa	7.383.439
435	Sigurime shoqerore	23.831.452
436	Sigurime shendetesore	3.358.741
437,438	Organizma te tjere shoqerore	0

Burimi i të dhënave: Grupi i Auditimit nga DPTH

Këto detyrime, janë likuiduar në vitin pasardhës, në muajin janar të vitit 2021. Për vitin 2020 nuk ka detyrime të prapambetura ose të papaguara.

□ Llogaria 42 óPersoneli e llogari të lidhura me toó

Llogaria e pagave të konstatuara të vitit paraqitet në lidhje me pagesën e dorëzuar në Tatime në fund të çdo viti.

Tabela nr.34: Shpenzimet faktike në lekë

Viti	Paga bruto	Paga per Sig Shend	Paga Per sig shoq	Sigurime shoqerore		Sigurime shendetesore		TAP	Ndalesa Permbarimi dhe ndalesa te tjera	Paga neto
				Shoq. PDH 15 %	Shoq PM 9,5%	Shoq. PDH 1,7%	Shoq PM 1,7%			
2016	99.067.893	98.814.235	95.810.868	14.371.729	9.102.058	1.679.835	1.679.835	8.101.308	164.886	80.019.806
2017	99.151.766	98.546.053	95.754.956	14.363.243	9.096.721	1.675.283	1.675.283	8.260.552	637.013	79.482.197
2020	152.908.404	152.205.719	146.240.237	21.936.036	13.892.823	2.587.497	2.587.497	13.406.612	64.617	122.956.855
2020 kontrate	7.804.955	7.804.955	7.804.955	1.170.743	741.471	132.684	132.684	597.316	186.935	6.146.548

Burimi i të dhënave: Grupi i Auditimit nga DPTH

Tabela nr.35: Shpenzimet faktike në lekë

Viti 2016	Shpenzimer fakt 2016	Detyrimet 2015	Detyrimet 2016	Fakt 2016 - Detyrimet 2015+ Detyrimet 2016	Kontabiliteti 2016	Diferenca
600 "Paga"	531.502.235	23.363.419	33.473.745	632.073.598	535.107.688	5.833.172
601 " Kontribute"	90.461.037				91.132.738	
Viti 2017	Shpenzimer fakt 2017	Detyrimet 2016	Detyrimet 2017	Fakt 2017 - Detyrimet 2016+ Detyrimet 2017	Kontabiliteti 2017	Diferenca
600 "Paga"	566.517.496	33.473.745	28.884.896	661.752.096	560.056.176	8.867.303
601 " Kontribute"	93.963.377				92.828.617	
Detyrime projekti 2016	5.860.072					
Viti 2020	Shpenzimer fakt 2020	Detyrimet 2019	Detyrimet 2020	Fakt 2020 - Detyrimet 2019+	Kontabiliteti 2020	Diferenca

				Detyrimet 2020		
600 "Paga"	1.269.426.235	35.211.215	36.313.972	1.481.124.873	1.267.771.217	19.842
601 " Kontribute"	210.595.881				213.333.814	

Burimi i të dhënave: Grupi i Auditimit nga DPTH

PASQYRA E PERFORMANCËS

SHPENZIMET

Për vitet 2016, 2017 dhe 2020 ASHK/ish ZRPP ka kryer shpenzimet korrente të pasqyruara në pasqyrën e shpenzimeve si burim financimi nga të ardhurat e veta. Shpenzimet e realizuara për llogaritë (600, 601) për të gjithë sistemin si më poshtë:

Tabela nr.36: Buxheti në vite për llogaritë 600, 601

në lekë

Viti	Llogaria	Buxheti fillestar VKM nr.1100 ,date 28.12.2015	Shtesë sipas vkm nr.302,date 20.04. 2016	Buxheti i rishikuar VKM nr.302,date 20.04.2016	Fakt	Teprica
2016	Paga Personeli (600)	584,000,000	30,864,000	614,864,000	531,502,235	83,361,765
	Kontribute Sig. (601)	96,900,000	5,154,000	102,054,000	90,461,037	11,592,963
Viti	Llogaria	Buxheti fillestar VKM nr.944 ,date 28.12.2016		Buxheti fillestar VKM nr.944 ,date 28.12.2016	Fakt	Teprica
2017	Paga personeli (600)	676,957,000		676,957,000	566,517,496	110,439,504
	Kontribute Sig. (601)	112,331,000		112,331,000	93,963,377	18,367,623
Viti	Llogaria	Buxheti fillestar VKM nr.117 ,date 13.02.2020		Buxheti i rishikuar VKM nr.575, date 22.07.2020	Fakt	Teprica
2020	Paga personeli (600)	1,497,268,674		1,497,268,674	1,269,426,235	227,842,439
	Kontribute Sig. (601)	248,862,403		248,862,403	210,595,881	38,266,522

Burimi: Përpunim nga grupi i KLSH

Referuar tabelës më sipër paraqitet realizimi i fondeve për llogaritë (600, 601) për vitet 2016, 2017 dhe 2020, ku rezultojnë një tepricë fondesh në shumën totale 489.870.816 lekë. Kjo diferencë ka ardhur si rezultat i mosplotësimit të strukturës organizative me numrin maksimal të punonjësve. Fondi tepricë trashëgohet në vitin pasardhës dhe përdoret kryesisht për llogaritë 230, 231 óInvestimetó në drejtim të dixhitalizimit të sistemeve të IT.

- Realizimi i fondeve për llogaritë (600, 601) për DPASHK/ish-ZQRPP si më poshtë:

Tabela nr.37: Buxheti plan - fakt

në lekë

Viti	Llogaria	Plani buxhetor 2016	Fakt	Teprica
2016	600 óPaga personelió	145,756,000	99,118,897	46,637,103
	601 óKontributeó	23,985,000	15,981,013	8,003,987
	Totali	169,741,000	115,099,910	54,641,090
Viti	Llogaria	Plani buxhetor 2017	Fakt	Teprica
2017	600 óPaga personelió	170,913,717	99,379,155	71,534,563
	601 óKontributeó	27,942,000	16,205,700	11,736,300
	Totali	198,855,717	115,584,854.64	83,270,862.03
Viti	Llogaria	Plani buxhetor 2020	Fakt	Teprica
2020	600 óPaga personelió	184,993,110	158,221,464	26,771,646
	601 óKontributeó	29,894,939	25,575,492	4,319,447
	Totali	214,888,049	183,796,956	31,091,093

Burimi: Përpunim nga grupi i KLSH

Referuar tabelës më sipër paraqitet realizimi i fondeve për llogaritë (600, 601) për vitet 2016, 2017 dhe 2020, ku rezultojnë një tepricë fondesh në shumën totale 169,003,045 lekë. Kjo diferencë

ka ardhur si rezultat i mosplotësimit të strukturës organizative me numrin maksimal të punonjësve.

- Rakordimi i të dhënave të evidentuara më sipër për llogaritë (600, 601) për DPASHK/ish-ZQRPP si dhe regjistrimi i tyre në pasqyrat financiare për vitet 2018 dhe 2019 si më poshtë:

Tabela nr.38: Krahasim i vlerave të raportuara me faktike

në lekë

Viti	Llogaria	Sipas Bankës	Deklarimet në Sistemin e Tatimeve 2016	Viti ushtrimor 2016+ (Janar - Dhjetor)	Pasqyrat Financiare 2016
2016	600 "Paga personeli"	99.118.070	18.883.201	99.118.897	99.082.070
	601 "Kontribute sig."	15.981.013	16.051.563	15.981.013	16.053.929
	Totali	115.099.083	34.934.764	115.099.910	115.135.999
Viti	Llogaria	Sipas Bankës	Deklarimet në Sistemin e Tatimeve 2017	Viti ushtrimor 2017 (Janar - Dhjetor)	Pasqyrat Financiare 2017
2017	600 "Paga personeli"	99.379.155	19.032.556	99.379.155	99.222.923
	601 "Kontribute sig."	16.205.700	16.038.526	16.205.700	16.038.529
	Totali	115.584.855	35.071.082	115.584.855	115.261.452
Viti	Llogaria	Sipas Bankës	Deklarimet në Sistemin e Tatimeve 2020	Viti ushtrimor 20120 (Janar - Dhjetor)	Pasqyrat Financiare 2020
2020	600 "Paga personeli"	158.221.464	31.358.403	158.221.464	158.090.838
	601 "Kontribute sig."	25.575.492	25.826.960	25.575.492	25.447.443
	Totali	183.796.956	57.185.363	183.796.956	183.538.281

Burimi: Përpunim nga grupi i KLSH

Tabela nr.39: Vlerat e llogarive 600, 601 në vitet 2016, 2017 dhe 2020

në lekë

Viti 2016			Viti 2017			Viti 2020		
600 "Paga"	601 "Kontribute"		600 "Paga"	601 "Kontribute"		600 "Paga"	601 "Kontribute"	
Fakti	Fakti		Fakti	Fakti		Fakti	Fakti	
Detyrimet e muajit Dhjetor 2016	Detyrimet e muajit Dhjetor 2016	3.003.533	Detyrimet e muajit Dhjetor 2017	Detyrimet e muajit Dhjetor 2017	2.680.130	Detyrimet e muajit Dhjetor 2020	Detyrimet e muajit Dhjetor 2020	4.552.591
Sistemime	Sistemime		Ndalesë nga paga gjorbë APP			Ndalesë nga paga gjorbë APP		
Totali	Totali		Total	Total		Total	Total	
Detyrimet e muajit Dhjetor 2015	Detyrimet e muajit Dhjetor 2015	2.976.633	Detyrimet e muajit Dhjetor 2016	Detyrimet e muajit Dhjetor 2016	3.003.533	Detyrimet e muajit Dhjetor 2019	Detyrimet e muajit Dhjetor 2019	4.791.426
Kthim page 2015								
Totali	Totali		Totali	Totali		Totali	Totali	

Burimi: Përpunim nga grupi i KLSH

Raportimi i shpenzimeve të ligjshme të programit EEP për llogaritë (600, 601) të cilat mbulohen me financim nga Projekti "Ofrimi i shërbimeve publike me në qendër qytetarin".

Bazuar në Manualin Operacional të Projektit (POM) shpenzimet të ligjshme që do të mbulohen nga projekti janë pagat dhe kontributi për sigurime shoqërore për Institucione Buxhetore dhe Jobuxhetore.

- Për Institucionet Buxhetore shpenzimet e ligjshme janë pagat dhe kontributet shoqërore për:
- ✓ Zyrat e Gjendjes Civile në 61 bashki të Ministrisë së Brendshme.

- ✓ Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit-AKSHI.
- ✓ Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara-ADISA
- Për Institucionet Jobuxhetore shpenzimet e ligjshme janë pagat dhe kontributet shoqërore për:
- ✓ Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (sot Agjencia Shtetërore e Kadastrës).

Në zbatim të angazhimeve të Marrëveshjes së Huas të ratifikuar me Ligjin nr. 3/2016, datë 28.01.2016, për Projektin e Ofrimit të shërbimeve publike me në qendër qytetarinë, ASHK/ish-ZRPP ka përgatitur raportimet financiare çdo tre muaj për vitet 2016, 2017 dhe 2020 për të gjithë sistemin lidhur me realizimin e shpenzimeve të programit EEP për llogaritë (600, 601) të cilat janë dërguara pranë ADISA/PMU

Për sa më sipër është hartuar edhe Projektraporti i Auditimit përcjell në subjekt me shkresë 1179/4, datë 14.12.2021. Subjekti ka konfirmuar Projektraportin me shkresën nr. 899/21, datë 21.12.2021 (prot në KLSH me nr. 1179/5, datë 22.12.2021)
Nga subjekti i Auditimit nuk u paraqitën observacione.

IV. ANEKSE

Aneksi 1: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga KLSH

Forma e opinionit

147. Audituesi duhet të japë një opinion të pa-kualifikuar nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse audituesi, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e audituesit sipas pjesës që flet për përcaktimin e llojit të kualifikimit që i bëhet opinionit të auditimit

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, audituesit duhet të diskutojë çështjen me menaxhimin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditimit

151. Audituesi duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditimit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se audituesi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Audituesit mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të audituesit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

Çnatyra e çështjes që i jep shkas modifikimit në d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe Çgjkimi i audituesit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Audituesi duhet të japë një opinion të kualifikuar nëse: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, audituesi arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse audituesi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Audituesi duhet të japë një opinion të kundërt nëse, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, audituesi arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Audituesi duhet të japë mohim të opinionit nëse, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, audituesi arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, audituesi bëhet i vetëdijshëm se menaxhimi ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin audituesi konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, audituesi duhet të kërkojë nga menaxhimi ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse audituesi jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e audituesit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e audituesit

157. Nëse audituesi e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, audituesi duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin Ëheksim i çështjes ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në çpjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionin e auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse audituesi e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e audituesit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e audituesit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të

përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shkurtime

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
TVSH	Tatimi mbi vlerën e Shtuar
ADISA	Agjencia e Ofritit të Shërbimeve Publike të Integruara
PMU	Njësia e Menaxhimit të Projektit
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
ZRPP	Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme
AKSHI	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së informacionit
SIQF	Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë
ST	Sistemi i Tatimeve
DTHT	Dega e Thesarit Tiranë
EEP	Eligible Expenditure Program

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT